MUZA nga BORDO COMPETITION

10
STILISTËT E RINJ
PREZANTOJNË
KOLEKSIONET

FASHION *Made in* ALBANIA

NË FOTO:
(NGA E MAJTA)

ANDROLA KAMBO
AFERDITA ONUZI
FADIL BERISHA
ENADA AT'NIKOLLA
EMINA ÇUNMULAJ
RUDINA MAGJISTARI
VALDRIN SAHITI
HELIDON HALITI

FOTOGRAFIA:
ERGYS ZHABJAKU

Unioni i Bashkive
Shqiptare në Rajon

BASHKIA TIRANË

PRISHTINA

KOMUNA E TETOVËS
MUNICIPALITY OF TETOVA
OPŠTINA TETOVO

PRIZREN

FERIZAJ

PRESHEVA

Komuna e Pejes

GJAKOVA

Komuna Rahovec

TUZI TUZ

BASHKIA GJIROKASTËR

20.12.1996

MUZA, *që na frymëzon!*

Nga Ilda Lumani

Të bëhesh pjesë e një historie në median shqiptare, është vërtet një arritje profesionale dhe personale. Andaj, kur na u kërkua nga Muza Competition, për të bashkëpunuar për revistën e tyre të parë, që do të dëshmonte dy edicionet e eventit të modës, që iu ka krijuar një dritare të gjithë të rinjve në fushën e stilimit, ishte një kënaqësi e dyfishtë. E para sepse eksperiencën tonë mund ta ndajmë edhe me simotra, që kanë qëllim promovimin e talentuarve, por edhe më shumë për faktin, se ky është i vetmi "dokument zyrtar" letër, që 20 finalistët e dy edicioneve të "Muzës" kanë. Ndaj shpresojmë se iniciativa e përkthyer në këtë botim, të përqafohet nga të gjithë pjesëmarrësit, mbështetësit, por edhe ndjekësit spontan, të një aktiviteti, që si rrallëherë ka bashkuar shqiptarët e gjithë trevave, në prekjen e ëndrrës apo edhe realizimit të saj.
Në faqet e këtij numri do të gjeni pikërisht rrëfimet e para të atyre, që me siguri do të jenë emrat e ardhshëm të modës. Personazhet e jurisë, të cilët janë emra të pakontestueshëm të fushës të së bukurës, nga fotografi Fadil Berisha, tek etnografia Afërdita Onuzi, stilistja dhe bashkëthemeluesja e revistës BORDO, Enada At'Nikolla, modelja botërore Emina Çunmulaj, stilisti me famë ndërkombëtare,Valdrin Sahiti, si dhe piktori Helidon Haliti u zgjodhën për të qenë edhe pjesë e këtij cover-i, si promotorët dhe mbështetësit e parë, të fashion-dizanjerëve të së ardhmes!
Me urimin që edicionin e tretë të Muza Competition, të ketë sa më shumë talente, shfletojeni këtë numër dhe bëhuni mbështetës të çdokujt, që ka nevojë të sjell në jetë ëndrrat!

SHTËPIA BOTUESE
mediaprint
SHTËPIA JUAJ E DIJES

MUZA nga BORDO
COMPETITION

Kryeredaktore
Ilda Lumani

Gazetarë
Olsi Kolami

Fotografia:
Fadil Berisha
Ergys Zhabjaku
Gent Onuzi
Mariglen Ballhysa

Design & Layout
Altin Aliaj

Bashkëpunuan
Greta Xhakolli
Mirselda Kile
Xhulian Kafexhiu

muzacompetition@gmail.com

muzacompetition.com

100% art MODË dhe stil jetese

Abonohu!



Na ndiqni

MERR PAKETËN E PLOTË TË BORDO:
REVISTË E PËRMUAJSHME,
PORTAL INFORMATIV, KANAL NË YOUTUBE,
DHE E PRANISHME
NË TË GJITHA RRJETET SOCIALE.

bordo.al

përmbajtje

MUZA nga BORDO COMPETITION

KOLONA

12 ERION VELIAJ

14 ANDROLA KAMBO

16 RUDINA MAGJISTARI

INTERVISTA

18 SARA HOXHA

66 AFERDITA ONUZI

73 HELIDON HALITI



78 ALISA DUDAJ

68

JURIA

AFERDITA ONUZI
EMINA ÇUNMULAJ
FADIL BERISHA
ENADA AT'NIKOLLA
VALDRIN SAHITI
HELIDON HALITI

EVENTI

MUZA COMPETITION 2

20 NATA FINALE

22 TAPETI I KUQ

26

KONKURENTET

KLARA KAZANI
FRENKI CEKO
VITORE NDRECA
SARA KADRIJA
BESA MAHMUDI
FRONTIN HASANI
ELITE SHERIFI
KEVSER EMINI
LIRIDONA HAJDARI
KLEVISA SHKABA

EVENTI

MUZA COMPETITION 1

74 TAPETI I KUQ

76 NATA FINALE

22

PROFIL

FINALISTET MC 1

KAONE DURIQI
ETNIK SHALA
KIARA MUSABELLIU
MAHMUDIJE NIMANBEGU
ELDA SULAJ
EDLIRA TERZIU
KEJDI BIRAÇI
VJONA GASHI
JETA JASHARI

MUZA

ERION VELIAJ

KRYETAR I BASHKISË TIRANË

Ka qenë një ditë plot emocione, që finalizohet me këtë mbrëmje me disa goca shqiptare, me dizajn, me shije, me estetikë, me disa nga punimet më të bukura shqiptare, që kanë zënë qendrën e kryeqytetit evropian. Vijmë në një shesh tjetër që quhet sheshi "Italia", simbolikë shumë e bukur se çfarë do të thotë të kesh miq si Italia, nga e cila është frymëzuar emri i këtij sheshi, për të kuptuar që nuk janë forcat ushtarake, nuk janë anijet, tanket, nuk janë avionët,…ndonjëherë fuqia është tek estetika, tek e bukura, moda, tek eleganca. Besoj që pas asaj që ndodhi në Ukrainë me Rusinë, të gjithë kujtohemi që miqtë, sidomos fqinjët nuk duhet t'i marrim për të mirëqenë. Ne jemi shumë krenarë për fqinjët tanë, duke filluar edhe nga ky emërtim i sheshit "Italia" por sidomos nga fakti që ne shqiptarët rrethohemi nga tanët, rrethohemi nga Kosova, nga Maqedonia e Veriut, nga Mali i Zi, Lugina e Preshevës dhe ndaj sot jam shumë i lumtur që për këtë fqinjësi që është më shumë se sa fqinjësi, është gjaku ynë, ne kemi dedikuar këtë edicion. Jam sot shumë mirënjohës për Unionin e Bashkive, për Andriolën e gjithë skuadrën që punon. Jashtëzakonisht krenar për gjithë kolegët që vijnë nga Kosova, për Shaqon, i cili jo vetëm na priti në Prizren, për Lidhen e Prizrenit. Sot në fakt kemi një lidhje tjetër por një lidhje e modës, estetikës, dhe etnografisë dhe jam vërtet krenar për presidenten Atifete Jahjaga, që na ka treguar që të drejtosh nuk do të thotë të provokosh. Do të thotë që të bashkosh, të dashurosh, të lidhësh njerëzit, jo të përçash njerëzit. Ndaj, jam vërtet krenar që sot kemi më të mirën e botës shqiptare. Meqë është koha e korrjeve të grurit, do tregoj diçka. E pyetën një njeri: "Ti ke misrin më të mirë në të gjitha fushat e Shqipërisë. Çfarë bën me farën?" Burri u përgjigj: "Unë farën time e ndaj me fqinjët e tjerë, me të gjithë njerëzit në fshat". Po tha ku është lidhja se ti je më i miri tha, ti nuk do që të tjerët të bëhen si ty. Ti do të vazhdosh të jesh më i miri. Ai tha: "bletët e fshatit, atë pjalmin e shpërndajnë kudo. Dhe në momentin që ata kanë një farë të keqe prishet edhe gruri im. Prishet dhe misri im, prishet dhe bahçja ime". Ndaj është shumë e rëndësishme që të kuptojmë që suksesi ynë është i lidhur me suksesin e cilitdo prej nesh. Dhe fara jonë e mirë do duhet të shoqërohet me një farë të mire të të gjithë atyre që na rrethojnë. Vetëm kështu mund të ecim përpara. Kush shesh mirë dhe bën mirë te fqinji i vet, sheh dhe bën mirë të familja e vet. Në finale për ta mbyllur, unë nuk e di kush do e fitojë çmimin, do ta hap tani; por di të them diçka që modelja që mori më shumë duartrokitje nuk ishte modelja që kishte detyrimisht veshjen më të bukur, dhe nuk e di a është modelja që është në këtë zarf, por ishte modelja që humbi këpucën por vazhdoi rrugëtimin. Unë besoj që fabula është shumë e bukur. Për ne shqiptarët, nuk është e rëndësishme, ose nuk është i rëndësishëm mjeti, instrumenti por është destinacioni. Ajo modelja ishte shumë e qartë që destinacioni, misioni është më i rëndësishëm se sa mjeti. Ndonjëherë mund të shkojmë zbathur, ndonjëherë mund të shkojmë me këpucë, ndonjëherë mund të shkojmë me veshje sportive, ndonjëherë me veshjet më të çmuara, por destinacioni është shumë më i rëndësishëm se sa mjeti, që i çon shqiptarët atje ku duhet, në familjen evropiane. Pas këtyre reflektimeve, faleminderit që më frymëzuat…

P.S. Përshëndetja e Kryetarit të Bashkisë, Erion Veliaj, para dhënies së çmimit të parë të edicionit të dytë të Muza Competition.

B4

Balkan Cities Network

Balkan Cities Network

Balkan Cities Network

Balkan Cities Network

Balkan Cities Network

Balkan Cities Network

Balkan Cities Network

Balkan Cities Network

Balkan Cities Network

Balkan Cities Network

Balkan Cities Network

Balkan Cities Network

Balkan Cities Network

Balkan Cities Network

Balkan Cities Network

Balkan Cities Network

Balkan Cities Network

Balkan Cities Network

Balkan Cities Network

Balkan Cities Network

ANDRIOLA KAMBO

DREJTORE EKZEKUTIVE E UNIONIT TË BASHKIVE SHQIPTARE NË RAJON

Muza Competition është një mundësi e artë për të gjithë të rinjtë nga qytetet shqipfolëse në rajon. Kjo platformë i krijon mundësi të rinjve të ndërtojnë trashëgiminë kulturore në 3 komponentë: në ekonominë krijuese, në inovacion dhe në turizëm.

Projekti "Muza Competition" në fokusin e saj nuk përfshin vetëm promovimit e tyre individual, por Muza në fakt ka edhe nje objektiv tjetër, tejet madhor i cili është se si t'i kthejmë të rinjtë tanë në promotorë të turizmit rajonal, me krijimin e start-upeve të reja në këtë fushë duke krijuar një rrjetëzim shumë të rëndësishëm ekonomik dhe atë të trashëgimisë kulturore në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Nga suksesi që Muza Competition pati vitin e kaluar, këtë vit krijon një dritare të re, të munguar për të rinjtë e talentuar në fushën e fashion dizajnit. Sjellim për herë të parë një revistë fashion-dizajn që i dedikohet tërësisht promovimit të vlerave dhe aftësive të këtyre të rinjve fantastik në industrinë e modës.

Dëshiroj të mos lë pa përmendur disa statistika shumë të rëndësishme të cilat tregojnë realisht impaktin që Muza Competition pati vitin e kaluar dhe suksesin e garantuar që po sjell këtë vit. Vjet ne patën 350 aplikime nga Shqipëria dhe rajoni, ndersa këtë vit patëm plot 1,150 aplikime që erdhën nga çdo cep i botës ku ka të rinj shqiptarë, aty ku ndodhet diaspora jonë. Dua të them, dhe ta theksoj fort që jehona e Muza Competition është një jehonë që bashkon shqiptarët, është një jehonë e cila do të ketë suksese absolutisht për t'u kthyer në një platformë më karakter ndërkombëtar.

Albanak
post events exhibitions conference

EVENTS | EXHIBITIONS | CONFERENCE

www.albanakpost.com

RUDINA

MAGJISTARI

PRODUCENTE &
PREZANTUESE TELEVIZIVE

Në një botë, ku me qindra mijëra veshje prodhohen çdo ditë, Muza Competition lindi si një dëshirë për të theksuar talentin e të rinjve shqiptarë në konceptimin, dizenjimin dhe realizimin e veshjeve moderne, për të risjellë vlerat e kostumeve tona të mrekullueshme tradicionale, të punuara nga artizanet shqiptare duararta, e pse jo me qëllimin e krijimit të një rrjeti të madh bashkëpunëtorësh, për të shkuar drejt një trendi të bukur në fushën e modës shqiptare.
Në programet e mia televizive ndër vite, gjithmonë ka pasur një hapësirë të rëndësishme për të rinjtë, për idetë e tyre origjinale, siç ka pasur për modën, stilin bashkëkohor të të veshurit, e po kështu për veshjet tona tradicionale, si një vlerë e çmuar të cilën ne shqiptarët duhet ta ruajmë fort. Shqiptarët e talentuar kudo ku janë, Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut, Mal i Zi, kudo në rajon dhe jo vetëm, kanë qenë gjithmonë një motivim me historitë dhe shembujt e tyre në intervistat e mia ndër vite.
Dhe ndodhi pikërisht në një nga ato takimet e këndshme me Andriola Kambon, ose Andriolën e "Unionit", siç e njohin të gjithë, ku bisedat frymëzuese me një filxhan kafeje përpara, të lindnin e të formëzonin idenë e realizimit të kësaj gare artistike, një projekt, sa i bukur e entuziazmues po aq edhe sfidues njëkohësisht.
Në momentin që shkruaj këto rreshta, është vetëm fillimi i kësaj iniciative gjithëpërfshirëse të shqiptarëve të rajonit dhe jam e bindur që më e mira do të bëhet, duke krijuar një ngjarje, efektet e së cilës të mos jenë thjesht gjurmë të bukura në kujtesën tonë, por të shërbejë edhe si një shtysë e rëndësishme për të mbajtur të freskët muzën artistike të dizenjuesve të rinj, artizanëve shqiptarë dhe sipërmarrësve të fushës së modës.

VELUR
SPA

Një oaz qetësie dhe relaksi në mes të kryeqytetit.

Llastojeni veten në luksin e trajtimeve holistike dhe krijoni një balancë të përkryer mes mendjes, trupit dhe shpirtit.

NË VELUR SPA DO TË GJENI:

Hammamin Tradicional Turk

Masazhe Relaksuese dhe Terapeutike

Trajtime Trupi

Trajtime Spa Fytyre

Mjekësi Estetike

Depilime për femra dhe meshkuj

Manikyr dhe Pedikyr Spa

Parukeri

Spray Tan nga Moroccan Tan

Sauna

Zonë Relax

Velur Your Life!

Rruga Sami Frashëri, Qendra Tregtare Metropol
Telefon 0692032900 | 042222550

MUZA

SARA HOXHA

E MREKULLUAR NGA MUZA

Sivjet për herë të parë Muza Competition pati si partner mediatik Top Channel, një nismë e cila është vlerësuar nga producentja Sara Hoxha si një nismë mjaft e vyer në vazhdën e filozofisë që ky televizion ka për të ruajtur vlerat e traditës shqiptare. Në këtë intervistë producentja pranon se është magjepsur nga krijimet e konkurentëve në edicionit të dytë të Muza Competition, ndërsa thekson gjithashtu se ky projekt është po ashtu një mundësi për tu kthyer në të ardhmen një program televiziv.

Sara, Top Chanel partner mediatik me Muza, si lindi ideja për këtë bashkëpunim?

Muza Competition tregoi që në zanafillë se ishte një projekt serioz në disa drejtime që Fondacioni Dritan Hoxha dhe Top Media i konsideron thelbësore në përparimin e shoqërisë sonë, si ruajtja e vlerave dhe traditës sonë estetike përmes ri-përtëritjes së tyre si edhe promovimit të talenteve të reja në industri të rëndësishme të kohës, si ajo e modës. Nuk mund të mos mbështesnim një event të tillë në vazhdën e punës sonë së përditshme për të promovuar vlera të historisë dhe prezantuar publikun e gjërë me lidhjen e ngushtë të shqiptarëve pavarësisht trevave ku jetojnë. Ndaj i thamë pro propozimit për t'u bërë pjesë e një gare që gërsheton të bukurën e të shkuarës dhe së ardhmes.

Si e vlerësoni promovimin e traditës në ekran, a duhet bërë më shumë?

Promovimi i traditës në ekran mund të ketë disa përfitime të rëndësishme. Ai mund të ndihmojë në ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe historike të një vendi. Gjithashtu, mund të promovojë ndjenjën e identitetit kombëtar dhe të nxitë interesin dhe kureshtjen tek audiencat për kulturat dhe traditat e ndryshme.

Në kohët që jetojmë duhet patur parasysh disa aspekte. Një ndër to është balanca e duhur midis promovimit të traditave dhe inovacionit të nevojshëm në industrinë e medias dhe argëtimit. Muza Competition e peshon këtë me kut-in e duhur duke i kthyer elementët e 'vjetër' në modernë, edhe sepse pjesmarrësit janë të rinj në moshë. Aplikimi i traditës në forma inovative është përbërësi kyç në përqafimin e saj nga brezat e rinj.

Si ju dukën koleksionet e Muza, a patët ndonje të preferuar?

Personalisht më pëlqen kombinimi i materialeve të rënda të traditës sonë lesh-punuese me copa më të lehta festive dhe ngjyra të ndezura si e kuqja. Jam e mrekulluar nga puna e shumë stilistëve për mënyrën se si kanë ndërthurur me kaq finesë të shkuarën me çfarë konsiderohet trendi tani, dhe ky edicion i ka kaluar pritshmëritë e të gjithëve.

Cilën prej veshjeve do të pëlqente ta vishje pa asnjë hezitim?

Çdo njërën prej tyre që nuk tregon shumë lëkurë, tek tonet e errëta.

Shumë janë frymëzuar nga tradita, gjyshet e tyre, a ruani kujtime të tilla nga fëmijëria juaj?

Patjetër, gjyshja ime thurte me shtiza deri në ditët e fundit.

A mund të bëhet Muza pjesë e një programi si She's On Top, apo reality?

Po e mendojmë shumë seriozisht për të bërë diçka të tillë. Programe televizive si "Project Runaway" apo të tjera në Netflix që kanë natyrën e MC kanë patur një audiencë besnike dhe mendoj e njëjta gjë mund të ndodhte me një version të Muza-s të ekranizuar. Potenciali është aty, ndaj duhet thjesht të gjejmë mënyrën më të bukur për të joshur publikun televiziv drejt kësaj përmbajtjeje.

BORDO STREAM









www.bordo.al

MC 2

Muza Competition

Mbrëmja finale e edicionit të dytë të Muza Competition ishte një festë e vërtetë e cila celebroi modën, artin dhe kulturën në kryeqytet shqiptar. Nata finale ishte një spektakël i cili u moderua nga prezantuesja e njohur Rudina Magjistari, ndërsa qindra spektatorë ndoqën parakalimet e modeleve me veshjet e konkurrentëve mbi pasarelë. Nata mori akoma më shumë ritëm kur në skenë u ngjitën për të interpretuar artistët Venera Lumani dhe Lind Islami, duke i dhënë akoma më shumë atmosferë Muza Competition. E në fund, ceremonia e ndarjes së çmimeve ishte vërtet mbresëlënëse, ku vetëm tre prej konkurrentëve fituan trofetë. Juria vlerësoi me çmimin e parë stilisten Klara Kazani, ku çeku prej 20 mijë eurosh ju dha nga kryebashkiaku i Tiranës Erjon Veliaj, ndërsa çmimi i dytë prej 10 mijë euro shkoi për Frenki Ceko dhe i treti prej 5 mijë euro për Vitore Ndreca. Në garë për të shkuar drejt finales së madhe aplikuan mbi 1 mijë të rinj e të reja nga të gjitha trojet shqipfolëse, por vetëm 10 prej tyre prekën natën finale, duke u vlerësuar në çdo fazë nga një juri prestigjioze, e përbërë nga: Afërdita Onuzi, Helidon Haliti, Enada At-Nikolla, Fadil Berisha, Valdrin Sahiti dhe Emina Çunmulaj.

NEW GENERATION
MUZA COMPETITION
VENDI I-rë
10'000 EURO
MUZA COMPETITION
VENDI I-rë
20'000 EURO



Hilfe zur Selbsthilfe



MC 2

Muza Competition

TAPETI I KUQ

Nuk kishte sesi të ndodhte ndryshe, eventi i vitit për modën dhe dizajnin këtë sezon ishte Muza Competition, ndaj edhe personazhe të njohur nga bota e televizionit dhe artit parakaluan me elegancë në taletin e kuq. Ceremonia u organizua në sheshin "Italia", ku të ftuarit duke respektuar kodin e veshjes, i cili ishte total black, parakaluan mbi tapetin e kuq, shkrepën foto dhe kujtime nga eventi si dhe shijuan nga një gotë. Ajo që ra në sy, përpos numrit të madh të të ftuarve, ishte fakti se ngjarjes më të madhe të modës dhe dizajnit në trojet shqipfolëse, ju bashkuan personazhe të njohur të ardhur nga Shqipëria, Kosova, Mali I Zi, Maqedonia e Veriut dhe diaspora. Në cermemoninë e tapeti të kuq nuk munguan edhe konkurrentët e vitit të shkuar. Edhe një herë organizatorët e Muza Competition arritën të konfirmonin se ky event jo vetëm që është i suksesshëm dhe me rëndësi të madhe në misionin e tij, por edhe tërheq një numër të madh të ftuarish.





MUZA event



NËN VELLO

KLARA KAZANI

FITUESE E MUZA 2

Vajza e cila zbuloi muzën e saj në edicionin e dytë të Muza Competition ishte Klara Kazani. Përmes koleksionit me titull "Nën Vello", stilisja e talentuar, e cila aplikon profesionin e mes Tiranës dhe Berlinit arriti të zbulojë frymëzimin e saj duke hulumtuar mes traditës së veshjeve popullore, historisë, mes fotografisë dhe hulumtimeve që ka bërë rreth periudhës së viteve 1940.

Të gjitha vajzat e kanë imagjinuar veten poshtë një velloje të bardhë nusesh, por askush nuk e ka imagjinuar veten të veshur me një vello si ajo që stilistja Klara Kazani ka dizenjuar enkas për koleksionin e Muza Competition. E frymëzuar nga dokumentimet rreth gruas shqiptare në Veri të Shqipërisë nga vitet 1900 – 1940, si dhe e ngacmuar nga filmi "Përtej mureve të gurta", ka krijuar një koleksion i cili nëse në fillim të sfilatës shfaqet e mbuluar me vello, pak nga pak nis e zbulohet, si një formë çlirimi. Koleksioni "Nën vello" ka për qëllim të kërkojë, kush është nën vello, kush është pas dyerve të shtëpive. Veshja nuk është personalitet, por personaliteti i gjithkujt e shtyn individin të vishet në forma të caktuara. Çdo individ mund të gjejë të paktën një veshje në koleksionin tim që do të donte ta vishte" – thekson stilistja Klara Kazani.

Klara si ka qenë eksperienca për të krijuar një koleksion unik për Muza Competition?

Eksperienca për të krijuar për Muza Competition ka qenë shumë sfiduese. Realizimi i një koleksioni me 10 veshje unike brenda një muaji e gjysmë për një dezajner është shumë i vështirë, sidomos me pritshmëritë në cilësi që unë kërkoj të arrij. Nga krijimi i kallëpeve nga a para deri tek krijimi i printimeve të frymëzuara nga kultura shqiptare, ky proces ka qenë shumë i ngarkuar. Ky koleksion është krijuar me qëllimin që të zgjerohet edhe në më shumë elemente dhe është bërë për një audiencë të caktuar, e cila mund të dëshirojë ta veshë. Pra, Muza ka qenë një iniciativë shumë e mirë për të ndërmarrë krijimin e një koleksioni me potencial që të shitet.

Keni zgjedhur një emër paksa misterioz për koleksionin, e quani: Nën Vello! Pse?
"Nën Vello" është inspiruar nga dokumentimet e grave shqiptare mes viteve 1900 dhe 1940 në Veri të Shqipërisë, gjithashtu paksa e ngacmuar edhe nga filmi përtej "Përtej mureve të gurta". Jam inspiruar nga gratë që mbuloheshin apo mbylleshin nëpër shtëpi, jo për të gjykuar arsyet pse, apo për të thënë që tani jemi më mirë se më parë, por për të vënë në pah që ne nuk dimë asgjë për botëkuptimin e gruas së motshme shqiptare, qofte ajo nën vello apo jo. Dimë që është një grua e fortë dhe stoike, një nënë heroinë, por për ndjenjat dhe ngjyrat e personalitet të saj dimë shumë pak. Koleksioni "Nën vello" ka për qëllim të kërkojë, kush është nën vello, kush është pas dyerve të shtëpive, me një koleksion plot personalitet dhe simbole. Veshja nuk është personalitet, por personaliteti i gjithkujt e shtyn individin të vishet në forma të caktuara. Mendoj që çdo individ mund të gjejë të paktën një veshje në koleksionin tim që do të donte ta vishte.

Termi që keni zgjedhur për të stilizuar është çfarë ka nën vello, a ka vërtet vello koleksioni?
Përpos shumë elementeve të tjerë të kulturës shqiptare, vello është inspirim kryesor për koleksionin, si nga ana e metaforës por dhe siluetat që vellot krijojnë kur vishen. Normal që koleksioni ka silueta që dukshëm janë marrë nga vellot, por vello tamam nuk ka në koleksion. Kam materiale dhe silueta që kanë ardhur prej vellove.

Jeni frymëzuar përmes fotografisë nga etnologët, si erdhi kjo ide, çfarë ju ngacmoi?
Inspirimet janë shumë personale, vijnë nga jeta. Muaj më parë takova një mikun tim etnolog, që përveç se studion kulturën tonë, gjithashtu kontribuon në kulturë duke risjellë këngë të vjetra të kënduara nga ai vetë. Kur vendosa të aplikoj për Muza Competition gjëja e parë që bën një dizajner është kërkimi, dhe Platori, miku im ishte personi i parë që më erdhi në mendje. Gjithmonë duhet t'i studioj kërkimet, të shkuarën dhe çdo lloj dokumenti që mund të gjej, para se të nis një koleksion. Nëpërmjet Platorit më erdhën në dorë disa burime me fotografi dhe skica të Robert Elsie, Edith Durham, Carleton Coon, Giuseppe Massani (sidomos shumë i rëndësishëm për koleksionin tim) dhe shumë të tjerë që kam shfletuar ato kohë para se të filloja me skicimet. Mendoj që jam shumë e kompletuar dhe gjithmonë ndjek intuitën, mendoj që intuita dhe vendimet e sinqerta e bëjnë diçka të veçantë. Pasi shfletova shumë libra dhe burime të fotografive, mbajta shënime çfarë më kishte bërë përshtypje dhe kështu lindi koleksioni.

Cilat janë elementet stilizues që spikasin më së shumti në koleksionin tuaj?
Siluetat e gjata dhe me kapuç janë një element stilistik shumë i përsëritur për koleksionit tim. Si rradhë në kompeticionin e Muzës kemi xhaketa Puffer. Gjithashtu printimet që kam krijuar vetë, duke marrë për bazë fotografitë janë një pjesë shumë e rëndësishme e këtij koleksioni. Një elemet tjetër shumë i përsëritur janë rripat e trashë të inspiruar nga brezat.

> *Gruaja që do të vishte "Nën vello" është një grua që pëlqen rehatinë në veshje si dhe të jetë unike. Është një grua joshëse dhe sex appeal që nuk ka nevojë të zhvishet*

Çfarë materialesh konkretizojnë Nën Vello, po aksesorët shoqërues?
"Nën vello" ka lëkurën e lopën, të deles, ka leshin e deles dhe fibra të punuara me grep që kam marrë drejt për së drejti nga inspirimet. Materialet e tjera janë më "ready to wear" dhe më të rehatshme si "jersey", denim, poliestër për xhupa dhe saten. Veshjet shoqërohen me shumë aksesore që shumica i kemi bërë vetë, si: byzykë metali, varëse me monadha hekuri, temina metalike si dhe disa unaza metalike.

Ju e konsideroni veshjen shprehje të personalitetit të gruas, si është gruaja që ju prezantoni?
Gruaja që do të vishte "Nën vello" është një grua që pëlqen rehatinë në veshje si dhe të jetë unike. Është një grua joshëse dhe 'sex appeal' që nuk ka nevojë të zhvishet. Duke qenë se veshjet zhvillojnë një mesazh, disa prej tyre mund të jenë të përshtatshme për këdo dhe disa janë bërë për karaktere më me shumë stil. Janë veshje që vishen nga njerëz me vetbësim dhe që i pëlqen kush kanë zgjedhur që të jenë. Veshja nuk është një zgjedhje, është një pasojë.

Gruaja moderne tenton të shfaqet, të bjerë në sy përmes veshjes, ju i shtoni një lloj kurioziteti, e bëni misterioze, e fshihni me vello, pse?
Veshjet janë një vello që fillon e zhvishet, kjo është silueta, një vello e rënë, që avash - avash gjatë koleksionit fillon bie dhe në fund shndërrohet në një grua të fortë. "Nën vello" është një metaforë. Të gjithë kur vishemi jemi nën një vello që mendojmë se kemi zgjedhur të përfaqësojmë, por në fakt ne vishemi si vishemi, sepse atë ofron tregu ose duam të dukemi ose të mos dukemi, pra kush do që të jetë "pasoja" ne të gjithë jemi nën vello. Ky koleksion është një farë velloje por edhe të zhvesh pak prej saj. Unë sinqerisht mendoj që ky koleksion është risi për tregun shqiptar, nuk e di nëse do të pëlqehet, por mendoj që do të inspiroj dhe të tjerë që thjesht të mos ndjekin një trend, por intuitën e tyre.

CREDINS 20 vite
KREDIA 48 ORË
HIDH HAPIN TJETËR!
• Shuma 1,000,000 lekë
• Pa kolateral, pa garantor
• Aprovim i shpejtë

FRENKI CEKO

ODE PËR TË KALUARËN

Nga një modele e suksesshme, Frenki Ceko provon një eksperiencë ndryshe, atë të stilistes dhe duket sa ja doli me sukses, duke fituar vendin e dytë në Muza Competition. Frenki e quan koleksionin e saj "Ode për të Kaluarën" një dedikim për heronjtë e heshtur, ata që mungojnë në faqet e historisë. Duke përdorur mjeshtërimin e tezgjahut dhe qëndisjes, Ceko ka sjellë elemente si xhokja e gruas mirditore apo fustanella në versione avangade, të pasuruara me detaje si kombinimi i lëkurës dhe kamoshit.

Frenki nga modele, tani stiliste, sa ju ka frymëzuar modelingu në botën e dizajnit?

Modelingu ka qenë përherë një rrugëtim në rritje dhe shumë multi-dimensional. Të punuarit për firma nga më të ndryshmet më ka bërë të shoh dhe vlerësoj më shumë çdo lloj stili, të kuptoj shumëllojshmërinë e materialeve dhe kombinimet e tyre, të dalloj përsosmërinë e një veshjeje dhe ta përshtas në mënyrën më të mirë të mundshme me modelen që do ta veshë, sepse çdo detaj ka rëndësinë e vet. Pasioni për modën më ka lindur që në fëmijëri, duke stiluar veshjet e mia. Sfilatat dhe Photoshooting e realizuar për brand-e nga e gjithë bota, më ka bërë t'i shoh veshjet si forma më e bukur e artit që dua të ndjek për karrierën time të së ardhmes.

Ode për të kaluarën – një dedikim për heronjtë e heshtur, cilët janë ata për ju?

"ODE për të Kaluarën" është pikërisht për heronjtë e heshtur, ata që mungojnë në faqet e historisë. Burra që luftuan në çdo mënyre për të mbrojtur identitetin e vendit dhe gra të cilat rriten dhe edukuan breza të tërë duke mos lënë pas edhe mjeshtërimin e tezgjahut dhe qëndisjes, me motive brilante të cilat sot tregojnë origjinalitetin e kombit shqiptar në botë dhe pasurinë e kulturës artistike të tij.

Xhoka e gruas mirditore, si vjen e stilizuar nga Frenki?

Ky koleksion risjell në fokus, me një dizajn avangardë, xhokën e gruas mirditore, një veshje me motive me origjinë pagane, e cila është një nga simbolet më të rëndësishme të hershmërisë dhe identitetit tonë iliro -arbnor. Në një nga fustanet më të veçantë të koleksionit është pikërisht ai me këtë simbol, të cilin e kam ndërthurur me 2 materiale kamosh dhe lëkure, ku mbi lëkurë kam pikturuar me dorë të lirë elementet gjeometrikë që e karakterizojnë këtë simbol, një punë e cila ka marrë më shumë se 16 orë për t'u realizuar.

Fustanella, një veshje tipike burrërore, si e keni kthyer në versionin femëror?

Fustanella dhe veshjet tradicionale të luftëtarëve shqiptarë vijnë të modernizuara në variantin femëror të tyre duke lartësuar forcën e gruas shqiptare dhe duke e nderuar figurën e saj, për të gjithë "luftën" që kanë bërë gjatë jetës për të ecur përpara, megjithëse në vështirësi të medha, duke rritur breza të tërë me një kulturë sa më të lartë. Dua që modelet e mia kur të dalin në pasarelë të duken si luftëtare të vërteta.



Nga veshjet me punime tejzgjahu dhe artizanale, ju keni zgjedhur materiale si lëkura, veluti dhe linoja, a ishte e vështirë përshtatja e tyre?

Koleksioni "Ode për kaluarën" është i guximshëm, goditës, i palëkundur dhe shumë dimensional. Ky koleksion kombinon materiale moderne si lëkura, veluti dhe linoja me motivet tradicionale të qendisura, duke krijuar kështu një urë lidhëse midis tradicionales dhe kontemporanes. Vështirësia në përshtatje të materialeve ka qenë e lartë, për këtë arsye ka qenë e nevojshme të bëhen shumë prova në qepje dhe eksperimente në teknika të ndryshme, por ka pas dhe ndryshime të papritura që vinin si pasoje e këtyre kombinimeve.

Duke studiuar traditën, e më pas duke e modernizuar, çfarë ju ka impresionuar më shumë?

Më së shumti më ka impresionuar fakti që Shqipëria një vend kaq i vogël, ka larmishmëri shumë të madhe në detaje të elementeve dhe motiveve tradicionale, prandaj dhe unë jam munduar të zgjedh disa dhe më të bukurat për mua ti risjell. Fakti që në çdo qytet që kalon gjen një shumëlloshmëri elementesh nga më të ndryshmit më ka impresionuar përherë për Shqipërinë.

Në të ardhmen Frenkin do ta shohim më shumë si stiliste apo modele?

Unë kam rreth 4 vite që punoj si designer për firma të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, si freelancer dhe fulltime, duke bërë koleksione për një shumëllojshmëri stilesh dhe klientesh. Në të njëjtën kohë kam vazhduar dhe karrierën dhe pasionin për modelingun duke qenë se kërkesat kanë qenë të larta për imazhin tim, dhe kam menaxhuar kohën mirë që t'i realizoj të dyja. Në të ardhmen modelingu do të vazhdoj me projekte shumë të përzgjedhura nga unë, por më shumë do të shfaqet emri im në botën e dizajnit dhe modës si stiliste.







NEW GENERATION
QENDËR MULTIFUNKSIONALE

ZGJIDH ARSIMIN PROFESIONAL

NË NEW GENERATION

REGJISTRIMET KANË FILLUAR!

PROGRAME STUDIMI 2 VJEÇARE **TË AKREDITUARA**
NGA AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMEVE
DHE KURSE PROFESIONALE AFATSHKURTRA

newgeneration_albania
Qendra Multifunksionale "New Generation"
(+355) 69 2037056
info@newgeneration-al.com

VITORE NDRECA

VEZA KOZMIKE

Bota krijuese e stilistes Vitore Ndreca është unike. Ajo krijon jo nga imagjinata, por nga një objekt konkret, siç është plisi, kozmosin e saj. Arrin të tjetërsojë, ridimensionojë dhe rikrijojë një simbol mashkullor, në pikën e fillesës dhe mbaresës, një koleksion feminil. Vitore Ndreca mjafton me një prekje të lehtë të plisit dhe nga ai nxjerr papritur perëndeshat e koleksionit që ka krijuar për garën në Muza Competition. "Nëse ky element simbolizon krijimin e njerëzimit, atëherë ne femrat e mbartim jetën brenda vetes, është një kurorë që doja t'ia vishja femrës në këtë koleksion të mbushur me perlat e lirisë dhe krenarisë" -thekson stilistja e talentuar.

Keni dizenjuar shumë koleksione, por çfarë kishte të veçantë Muza?

Unë kam eksperimentuar me shumë koleksione që nga krijimi i Gadov Couture dhe ndjesia ka qenë shumë e veçantë për secilin, por ajo që kam dashur gjithmonë të bëja ishte një temë e veçantë në lidhje me historinë e veshjeve të popullit shqiptar, dhe Muza erdhi në kohën e duhur. Koleksioni i Muza është shumë i veçantë sepse më dha lirinë që të eksploroj në tre kohë njëkohësisht brenda një koleksioni, e kaluara e tashmja dhe e ardhmja. Liria ime si dizajner për të krijuar në kohët e sotme në një vend të lirë, me një femër të lirë, me një të ardhme të lirë, më bën të ndihem shumë mirë. Prandaj dua që Muza të jetë gjithmonë kjo ndjesi lirie për çdo dizajner e të vazhdojë sa me gjatë.

Veza Kozmike- Plisi, keni zgjedhur një titull paksa futuristik, çfarë ju frymëzoi?

Plisi ose qeleshja që mbante në kokë gjyshi im ka qenë njohja me këtë element që në fëmijëri. Qeleshja ishte krenaria e një burrërie, simbol fisnikërie e krenarie, simbol shumë i shenjtë për kulturën që e vishte dhe ruhej me shumë fanatizëm. Më pas duke studiuar për historinë e qeleshes pashë se edhe vetë Zeusi mbante në kokë simbolin e qeleshes, po ashtu edhe Aleksandri i madh i Maqedonisë, Akili e shumë të tjerë. Veza kozmike është simboli i krijimit të botës dhe e përhapur në të gjitha kulturat mitike të Mesdhetut, përmbledh gjithësinë dhe unë ndihem e dashuruar me historinë ndër shekullore të këtij simboli. Më pas Helena e Trojës dhe perëndeshat e kanë mbajtur plisin në kokë. E pikërisht nga madhështia e këtij simbolizmi në historinë mitologjike e mora frymëzimin të krijoja hyjneshat e mia në këtë koleksion.

Çfarë përfshin ky koleksion konkretisht, gama e veshjeve dhe e aksesorëve?

Koleksioni përfshin një linjë të pastër të nuancave të bardha që nga fillimi deri në fund. Secila veshje ka një emër dhe një histori në vetvete dhe janë plot 10 emra, me 10 histori magjike. E përbashkëta në këto veshje është tejdukshmëria, janë korsetë e tejdukshme në nude, e cila thekson belin dhe nxjerr në pah format e bukura të femrës. Po ashtu, kjo lloj tejdukshmërie sot vesh me liri të plotë edhe simbolet e kulturës më konservative të kaluarës sonë. Është një miksim shumë i veçantë ndërmjet së tashmes e cila mbart të kaluarën dhe ëndërron për të ardhmen. Janë përdorur një gamë shumë e gjerë aksesorësh që nga materialet e forta deri tek fijet e arit të qëndisura mbi shifonet e mëndafshta.

Plisi është thjesht një aksesor, çfarë huazuat nga ai për të krijuar vezën tuaj kozmike?

Plisi është një simbol që është veshur nga meshkujt në kulturën shqiptare dhe mban shumë krenari në vetvete, por edhe nga perëndeshat dhe femrat e historisë mitike duke më dhënë lirinë të guxoja. Nëse ky element simbolizon krijimin e njerëzimit, atëherë ne femrat e mbartim jetën brenda vetes. Është një kurorë që doja t'ia vishja femrës në këtë koleksion të mbushur me perlat e lirisë dhe krenarisë. Pas një tranzicioni jo shumë të largët në të kaluarën, femra shqiptare vazhdon edhe sot të thyejë tabu dhe kjo më pëlqen shumë.

Cilat janë materialet që keni përdorur për t'i dhënë jetë veshjeve të koleksionit?

Në koleksion ka një shumëllojshmëri materialesh. Janë përdorur më shumë se 1200 metër fije plastike e manipuluar në organza e mëndafshe për të krijuar format abstrakte që do të japin efektin kozmus të ecjes në kohë në këtë koleksion. Pastaj vijnë materialet e leshta të cilat janë shtypur dhe transformuar në forma të ndryshme për detaje të veçanta në koleksion, gjithashtu janë përdorur shiritat në ar, qëndisjet e simboleve me perla dhe rruaza në kronoline, janë përdorur mëndafshet e holla të qëndisura në ar si dhe punimet me grep në lulet 3D, të cilat shkojnë në një harmoni shumë të bukur me pjesën tjetër.

Qëndisma me ar, punime grepi dhe perla, gërshetimi i artizanit me modernen, si rrinë bashkë?

Qëndrojnë shumë bukur bashkë dhe krijohet një magji e vërtetë. Është një sfidë në vetvete sepse duhen respektuar simbolet tradicionale të pandryshueshme në historinë e tyre dhe të vendosen me zgjuarsi në veshjet moderne të sotme. Për shembull, të qëndisësh një qeleshe me rruaza dhe perla dhe ta vendosësh si kurorë mbi vello në kokën e një vajze është diçka shumë e veçantë dhe emocionuese, ose të qëndisësh simbolin e diellit e të yjeve në një fustan nusërie në ditët e sotme e bën shumë të veçantë.

Jeni dalluar për elegancë në dizajn, a do ta ruani ende këtë element në Muza?

Sigurisht që po! Eleganca është një ndër elementet që do të vihet re në këtë koleksion dhe jam shumë e lumtur për këtë. Puna në atelier më ka bërë të kuptoj se eleganca nuk ndryshon asnjëherë, është gjithmonë e re, është gjithmonë trend, e sigurtë dhe nuk gabon kurrë.

A kemi një traditë e cila mund të frymëzojë stilistët për të masivizuar atë në ready to wear?

Nuk di të them nëse kemi një traditë sepse prurjet e modës në ditët e sotme janë shumë të vrullshme e të larmishme, por di të them se kemi një pasuri elementesh kulturore dhe ka vend pafund për t'u frymëzuar dhe masivizuar në "ready to wear", mjafton të respektohen e të nderohen ato simbole dhe elemente për atë histori që mbartin në vetvete.

finalistë

MUZA

MRIZI I ZANAVE

AGROTURIZËM

www.mrizizanave.al **Mrizi i Zanave Agroturizem** **+355 69 210 8032**

SARA KADRIJA

GRUAJA

E FORTË SHQIPTARE

Një shpirti krijues si Sara Kadrija, nuk mund të shpëtojnë detajet e veshjeve të grave të bukura të lagjes së njohur të Shkupit, Çarshia. Shumica e tyre kishin të gdhendur portretin e gruas tipike shqiptare, të nënës sakrifikuese deri në vetmohim, por që për stilisten e re, detajet e punuara me gjilpëra në veshjet e tyre kanë shërbyer si frymëzim për të krijuar koleksionin "Gruaja e fortë shqiptare". Duke ndërthurur motivet e kësaj krahine me street style, Sara ka arritur të krijojë një koleksion magjepsës dhe elegant, i cili shpërfaq rrugën drejt një karrierë plot dritë në të ardhmen…

Nga momenti i aplikimit deri në shpalljen finaliste në Muza, si ka qenë ky proces për ju?

Ka qenë një proces me të papriturat e saj. Mund të them që ka ngjallur tek unë edhe emocione frike, por edhe emocione shumë të forta, të admirushme sepse të jesh në mesin e 1000 konkurrentëve është një sfidë e madhe. Dhe në momentin që e sheh veten si finaliste, kjo gjë ka një domethënie shumë të madhe për mua, sepse të vlerësohemi si dizajnera të rinj nga një juri prestigjioze, më jep ndjenjën e të qenit edhe më e afeksionuar me punën time si dhe njëherazi është edhe një shtysë për të vazhduar më tej në rrugëtimin tim. Kuptohet ka qenë një periudhë me plot punë, frikë, dashuri, stres dhe endje e madhe për të parë veten në këtë korrelacion të ndërthurur emocionalisht për finalen e madhe duke dhënë maksimumin nga vetja për këtë koleksion.

Më tërhoqi emri i koleksionit tuaj: Gruaja e fortë shqiptare! Pse pikërisht kjo zgjedhje?

Po pra, gruaja e fortë shqiptare. Kjo është gjeja e cila gjithmonë më prek thellë në zemër. Duke e ditur se femra apo gruaja shqiptare ka qenë gjithmonë një nënë, një grua, një vajzë e cila gjatë tërë jetës së saj me çdo kusht ia ka kushtuar familjes së saj, duke i bërë ballë çdo lloj sakrifice që i ka sjellë jeta dhe përskaj të gjithave, gjithmonë para fëmijëve të saj dhe njerëzve të tjerë është treguar e fortë, e bukur, e buzëqeshur, duke lënë anash gjithmonë anën e saj të errët, të vuajtjeve dhe sakrificave. Një zonë e vendit tim e quajtur gratë e veja, ndodhet në Çarshi të Shkupit, ku gratë shqiptare ishin të veja dhe vetëm për të mbajtur gjallë fëmijët e tyre, për t'u ofruar atyre kafshatën e bukës, detyroheshin të bënin punë dore me grep apo gjilpëra për të siguruar mbijetesën e familjes së tyre, andaj këtë koleksion kam vendosur ta titulloj "Gruaja e fortë shqiptare"

Si është për Sarën gruaja e fortë shqiptare në aspektin fashion?

Gruaja e fortë shqiptare në askpetin fashion është një femër e pavarur, e zonja e vetes, e cila gjithmonë ia del mbanë, pavarësisht të gjitha errësirave që mund t'i sjellë jeta. Femra shqiptare në sy të të tjerëve gjithmonë është një grua e fortë, e qëndrueshme, me stilin dhe elegancën e saj, tërheqëse, e bukur, më mahnitshmja e rruzullit tokësor do ta quaja në shijet e mia.

Çfarë stili e karakterizon koleksionin tuaj dhe nga çfarë jeni frymëzuar?

Koleksionin tim e karaterizon më shumë "ready to wear", diçka më e kapshme për t'u veshur, një stil më klasik, sepse nuk më pëlqen shumë avangardia. Gjithmonë jam në shijet e "street style" përzier me elegancë, diçka më e zakontë dhe klasike. Në koleksionin tim jam munduar të sjell diçka që është më unike dhe komode për stilin e femrave, që të ndihen sa më të lirshme me veshjen e tyre, por edhe të duken sa më bukur. Frymëzimi im kryesor ka qenë gruaja shqiptare duke përdorur stilizimin e punës me gjilpërë, por atë e kam rikthyer në trendin modern që të duket diçka sa më frymëzuese dhe joshëse për publikun. Kuptohet në këtë koleksion kam përdorur ngjyrën e zezë në veshje për të shfaqur pjesën e sakrificave dhe sfidave të gruas shqiptare si dhe ngjyrën e bardhë në pjesë të vogla, të prera drejt, për të shfaqur atë copëzën e dritës që kishin ato për të ardhmen, se një ditë do të bëhet më mirë mirë. Motivi kryesor që e karakterizon gjithë koleksionin janë motivet me gjilpërë në formën e luleve të stilizuara në stilin tim, për të treguar butësinë, shkëlqimin dhe buzëqeshjen e femrës shqiptare, e cila është gjithmonë shumëngjyrëshe në sferat e jetës.

Ju thon: ky projekt synon të shfaqë brendinë tuaj, si është kjo brendi?

Po patjetër, pasi hapi i parë në jetën e çdo dizajneri mendoj që është të shfaqë brendinë e tij para një opinoni të gjerë. Shpirti i një artsisti gjithmonë është i mbushur me fshehtësi dhe imagjinata të ndryshme dhe sa herë çdo artist me punën e tij tregon një pjesë të jetës, për të dhuruar diçka të bukur me krijimtarinë e tij. Edhe unë si një dizajnere e re mendoj që përmes dizajneve të mia të shpalos brendinë time, që populli të njihet me botën e shpirtit tim, me pikat e mia të forta në koleksion. Çdo veshje që krijoj ka një frymëzim nga e kaluara, aty dua të godas për të ardhmen siç ishte edhe ky koleksion i cili tregon pak a shumë jetën e errët dhe dritën e shpresës. Kuptohet shpirti im tregon edhe përpjekjet e mia për të arritur deri këtu.

Cila është pika e fortë e Sarës në këtë kompeticion?

Pika ime më e fortë është goditja mbi të kaluarën, duke e sjellë si një luftë të fituar me shumë djersë për të ardhmen, sepse jo gjithmonë lufta mund të tregohet me armë, por kur tregohet në mënyra artistike, duke goditur pjesë të jetës, mendoj që atëherë është pika më e fortë e një artisti.

Ku e shihni veten pas Muza Competition, cilat janë projektet e të ardhmes?

Pas Muza veten e shoh në këtë rrugë që kam nisur me shumë zell, duke punuar fort e me shumë dashuri në botën e dizajnit tim, e cila është edhe fryma ime e jetës. Do të vazhdoj të merrem edhe me projekte të tjera në vijim, të cilat i kam në plan, por kuptohet shpresoj të realizohen rrugës.

finalistë

MUZA

BASHKITË PËR NË EVROPË
Një projekt i financuar nga BE

BASHKITË PËR NË EVROPË II

Objektivat dhe rezultatet e pritshme

2021 - 2024

WE'RE BACK!

"Bashkitë për në Evropë", një projekt i financuar nga Bashkimi Evropian, ka nisur në 1 korrik etapën e dytë të rrugëtimit të tij. Ne synojmë që, përmes forcimit të kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit, të mundësojë afrimin e mëtejshëm të organeve të pushtetit lokal dhe qytetarëve, me Bashkimin Evropian.

QR code

OBJEKTIVAT TONA

NDËRTIMI I INSTITUCIONEVE

Përfundimi i procesit të ngritjes së Njësive të Integrimit, si pjesë integrale e strukturës organizative të Bashkive

NDËRTIMI I KAPACITETEVE

Fuqizimi i stafeve të NJIE, për informimin e kolegëve, mbi politikat e BE dhe veçanërisht proçesit të negociatave

QASJA NE FONDET E BE

Mbështetje për rritjen e numrit të aplikimeve në projekte nga ana e bashkive

TRAINIME MBI ÇESHTJET E BE

Pasurimi i kurikulës së trainimeve dhe librarisë së ASPA për çështjet e lidhura me Bashkimin Evropian

VLERESIMI I PERFORMANCES

Mbështetje për rritjen e kapaciteteve të bashkive, për menaxhimin e procesit të Vlerësimit të Performancës

KOMUNIKIMI & INFORMIMI

Fuqizimi i rolit të NJIE në përhapjen e informacionit mbi BE, përmes Këndeve të BE

www.bpe.al
info@bpe.al
Rr. Ismail Qemali
P.18, K.5, Nr.25,1019
Tirana, Albania
Mobile:
+355692052966

BESA MAHMUDI

SKREPA

Me kuriozitetin e një fëmije, Besa Mahmudi, as që do ta kishte menduar që kërshëria që kishte nisur ta ngacmonte duke krijuar byzylykë me rruaza, do të kthehej në qëllimin dhe pasionin më të madh të jetës së saj. Pasi u shpall finaliste e Muza Competition, pak nga pak, nisi të gërmojë në kujtimet e saj duke vendosur që të frymëzohet nga veshjet popullore të Rekës së Epërme për të krijuar koleksionin me të cilin zgjodhi të garojë në finalen e madhe. Në këtë intervistë, Besa rrëfen të gjitha shkëndijat që e frymëzuar për koleksionin "Skrepa".

Besa, si ka lindur pasioni për stilimin?

Hapat e parë kanë filluar nga fëmijëria, ai ka qenë fillimi i lulëzimit të diçkaje të re brenda meje, nga atëherë ka lindur pjesa e procesit të krijimit të gjërave të bukura, nga ideja dhe gjithë procesi i realizimit. Gjithmonë më kanë tërhequr gjërat e bukura dhe në çdo moment mendoja të krijoja diçka te re. Hapat e para ishin të vështira, se jo çdo herë që e mendoja realizohej në mënyrën e duhur. Por u desh shumë këmbëngulje dhe mund derisa arrita të profesionalizohem në këtë degë .

A ka pasur një person në jetën tuaj i cili ju ka frymëzuar?

Unë gjej frymëzim në një shumëllojshmëri njerëzish dhe gjërash. Inspirimin e parë e kam marrë nga nusja e xhaxhait tim, e cila punon si rrobaqepëse dhe në moshën kur isha fëmijë kisha akses të shoh mënyrën e realizimit të veshjeve nga ku e gjeja frymëzim për të krijuar. Pastaj familja pa dritë te sendet të të cilat zgjoja interes, më jepnin kurajë që të vazhdoj të punoj dhe se gjithçka arrihet përmes përpjekjeve dhe punës së palodhshme, nga ku nuk duhet të mungojë edhe durimi. Në kohën e gjimnazit fillova të ndjek mësime tek një atelie e modës në mënyrë më profesionale dhe fillova të ndërtoj bagazhin tim për aventurën e ardhshme, të cilin e zgjodha edhe ta studioja.

Si do ta përshkruaje koleksionin tuaj me të cilin konkurruat në Muza?

Me koleksionin tim dëshiroj të nxjerrë në pah vlerat e veshjes popullore të Rekës së Epërme nga ku mund të kuptojmë shumë qartë traditën dhe kultivimin e kulturës shpirtërore dhe materiale të atij vendi. Koleksioni im do të mbajë formën gjeometrike dhe minimaliste të siluetës, me qëllim që të krijohet një pamje artistike, e thjeshtë dhe modeste, ku bien në sy detajet e punuara me rruaza shumëngjyrëshe dhe copë të shndritshme metalike me ngjyrë argjendi (monedhat).

Koleksioni juaj quhet "Skrepa", pse keni zgjedhur këtë emër?

Skrepa quhet shamia e brezit, nga e cila e kam marrë inspirimin për ta krijuar këtë koleksion. Ato punohen në një dërrasë të gjatë, ku në të dy anët ngulen aq gozhda sipas motivit që dëshirojmë ta përfaqësojmë. Rruazat punohen më fije peri të rëndomtë, të cilat radhiten në mënyrë që të formojnë dizajnet përkatëse.

A ka pasur ndonjë element që ju ka frymëzuar më shumë?

Në moshën kur isha në shkollën fillore zgjoja shumë interes në krijim e byzylykëve shumëngjyrëshe. Rruazat i merrja nga materialet e mbetura te fustanet që qepte nusja e xhaxhait tim. Me byzylykun në dorë, shkova në shkollë, të gjitha shoqet ma pëlqyen, njëra nga ato më tha se ka shumë nga këto rruazat në shtëpinë e saj, pasi mami i saj i përdorte për të krijuar veshjen e tyre tradicionale. Gjithmonë më ka ngjallur interesuar ajo veshje. E kam parë në fotografi nga ku nuk mund të dalloja qartë pjesët e punuara me rruaza dhe detajet që përmban ajo veshje.Vendosa të lexoja më shumë dhe të shkoja tek një fqinjë që ta shikoja nga afër se si duket.

Duke studiuar veshjet tradicionale çfarë ju ka impresionuar më shumë tek to?

Mënyra se si i kanë radhitur dhe formuar figurat. Në një pjesë të veshjeve dhe aksesorëve vërehen qartë motivet gjeometrike, florale dhe ato zoomorfe, ku dallohet dallëndyshja, flutura, palloi dhe bleta. Në simbolikën ilire shpezët shtegtare përgjithësisht

kanë të bëjnë me simbolin solar. Vetë shpezët simbolizojnë fuqinë e dritës dhe luftojnë kundër fuqive të errësirës. Dielli, por edhe shumë motive të tjera ilire të lidhura me mite e besime të lashta, përdoren edhe sot gjerësish, ashtu si e gjejmë në ornamentikën e veshjes popullore të Rekës së Epërme.

Po për sa i takon materialeve që keni përdorur cilët janë?

Materiali bazë për krijimin e koleksionit është sateni me ngjyrë të bardhë. Kam vendosur që të përdor një material modern dhe ngjyrën e bardhë me qëllim që të lë hapësirë të mjaftueshme dizajnimit të rruazave nëmënyrë që ato të dalin sa më shumë në pah.

Nga folku ju merrni rruaza apo monedha, për të krijuar një siluetë minimaliste, a është e mundur që nga tradita të krijosh një stil modern?

Duke qëne që veshja nga e cila jam inspiruar është shumë e ngarkuar, vendosa që me një minimalizim në siluetë, të krijoj një stil modern. Të kesh si inspirim traditën duhet patur shumë kujdes në interpretimin e dizajneve, me qëllim që të ruhet origjinaliteti i saj.

Po aksesorët shoqërues cilët janë dhe sa rëndësi kanë për të plotësuar outfitt-in?

Aksesorët r përdorur janë kurora me lule, zbukurime që do të lëshohen nga flokët me monedha të renditura, vathë të punuara me rruazat shumëngjyrëshe, të cilat do të kompletojnë veshjen dhe do të plotësojnë idenë e gjithë koleksionit.

Çfarë ishte për ju pjesëmarrja në Muza Competition?

Muza Competition paraqet hapin timin të parë drejt rrugës së dizajnit tashmë si profesioniste, një mundësi e mirë për të treguar talentin, aftësitë e mia dhe mbi të gjitha paraqet një sfidë me veten. Bukuria e pjesëmarrjes në këtë konkurs është se rezultati varet nga aftësitë tona, dhe kënaqësia të zotërosh diçka është e pakrahasueshme. Pra, të sfidosh veten, domethënë të sfidosh botën.

finalistë

MUZA

Hilfe zur Selbsthilfe

HELP – HILFE ZUR SELBSTHILFE E.V.
ËSHTË NJË ORGANIZATË NDËRKOMBËTARE HUMANITARE GJERMANE E CILA OFRON NDËRHYRJE EMERGJENTE DHE PROGRAME ZHVILLIMORE NË MBI 25 SHTETE TË BOTËS.

Help operon në Shqipëri që nga viti 2020 dhe programet e saj janë përqendruar në:

- Nxitjen e punësimit/vetëpunësimit dhe inovacionit,
- Mbështetjen e fermerëve, ndërmarrjeve mikro/të vogla/të mesme/start-up-e/ndërmarrjeve sociale përmes ngritjes së kapaciteteve, ndihmës për gjenerimin e të ardhurave (IGA) dhe granteve;
- Rehabilitimit të ndërtesave publike arsimore/sociale dhe ofrimi i shërbimeve sociale;
- Integrimin shoqëror për të rinjtë dhe gratë në zonat rurale dhe urbane, romët/egjiptianët, ish të burgosurit, të rikthyerit nga emigracioni dhe personat e zhvendosur;
- Ekonominë e gjelbër dhe qarkulluese,
- Ndihma humanitare në katastrofat natyrore apo shoqërore.

Help – Hilfe zur Selbsthilfe e.V. Zyra e Shqipërisë

Rruga Tish Daija, Kompleksi KIKA 2

Godina 1C9, Hyrja nr.9, Kati i 7, Apt.7A
1020, Tiranë

METANA

BY FRONTIN HASANI

Dizajneri nga Kosova Frontin Hasani ka fatin të jetë djali i vetëm mes të gjithë finalistëve, por kjo nuk e bën të ndihet me fat përballë 9 vajzave, përkundrazi atij i duhet të jetë shumëfish më i disponueshëm për të krijuar një koleksion Metana. Stilisti ka zgjedhur pikërisht këtë emër për të etiketuar një koncept të vajzës moderne, e cila ka një look të plotësuar, ku spikasin siç thotë Frontini elemente si stolitë e arit dhe një fustan elegant, që plotëson të gjithë outfitt-in e saj. Në këtë koleksion ai frymëzohet nga veshjet e dy krahinave, Hasi dhe Presheva, elemente të cilët i ka qëmtuar me shumë kujdes për të krijuar një paradë vërtet elegante që i ka të gjitha në një.

Frontin, si ndihesh që je i vetmi djalë mes finalistëve të Muza Competition?

Tani, le të themi të drejtën nuk është që ky fakt nuk më pëlqen dhe ende më shumë gëzohem, që nga ata 1250 konkurrentë jam vetëm unë djalë, por le të themi të drejtën kjo "luftë" e bukur është më e vështirë, kur kundrejt teje ke të gjitha ato vajza super të talentuara.

Koleksioni juaj quhet "Metana", pse ky emër, çfarë domethënie ka?

Për emrin "Metana" jam inspiruara nga ajo që më së shumti kam dëgjuar, vajzat e bukura me stoli ari, fustane të bukura e shumë karakteristika të tjera. Sa herë që njerëzit kanë rastisur ti shohin i kanë etikuar me shprehjen: Kjo te koka Metana. Pikërisht në këtë koleksion jam munduar të sjell një vajzë të kuruar deri në detajet e fundit që realisht i ka "Metana"

Veshjet tuaja janë delikate, ndërsa koleksioni "Metana" sjell një vajzë të fortë, si është ajo?

Kjo vajzë ka vite që udhëton, ka kaluar shumë kohëra dhe padyshim që stili ka evoluar, por pavarësisht të gjithave, ajo nuk ka harruar se kush ka qenë, kush është dhe kush do të jetë: që do të thotë në çdo dalje të saj, ajo ka përdorur detaje nga veshjet tradicionale nga krahina që ajo vjen, duke i gërshetuar ato me trendet e reja.

Keni zgjedhur motivet nga Hasi dhe Presheva, çfarë ka qenë inspirim për ju tek këto veshje?

Eleganca, finesa dhe ajo pastërtia që karakterizon këto dy zona më ka bërë që të jetë pikënisje e inspirimit për të realizuar koleksionin "Metana".

Dy zona të ndryshme, me dy veshje të ndryshme, si keni arritur t'i gërshetoni ato?

Po vërtet janë dy zona të ndryshme, në një koleksion prej 10 veshjesh. Sigurisht që nuk është gjëja më e lehtë, por më e bukura që kam bërë ndonjëherë. Duke qenë një komb, veshjet tona tradicionale padyshim që kanë edhe ndryshime nga zona në zonë, por që kanë një tip bërthame të njëjtë.

Bardhë e zi, një zgjedhje e pavdekshme, me frymë minimaliste, si e keni konceptuar?

E bardha dhe e zeza kanë udhëtuar me vite e vite me trendet e modës, por edhe pse trendet kanë ndryshuar, e bardha dhe e zeza kanë qenë në çdo tendencë, ndaj nëse i analizojmë thellësisht mund të themi lehtësisht se ato nuk kanë për të humbur asnjëherë.

Sa e mundur është që motivet popullore të kthehen në stilin e përditshëm?

Mendoj se nuk është shumë e lehtë, sepse do të mund që të mos duken si një plagjiaturë. Por, ajo që i bën të veçanta veshjet tona është se kanë pasur gjithmonë një mesazh të qartë, që stili dhe trendet kanë qenë pjesa e kombit shqiptar, pa u shkëputur asnjëherë dhe kjo i dhuron një lehtësi punës tonë.

Ju thoni:filigramet e arit nuk vdesin kurrë, si e keni sjellë këtë detaj në koleksionin tuaj?

Këto element e kam sjellë në koleksionin tim përmes detajeve të perlave dhe të arit, te cilat janë punuar me dorë në mënyrën më të mirë të mundur. Mos të harrojmë se zona e Hasit njihet shumë për punën e jashtëzakonshme të dorës në veshjet e saj.

Si ka qenë eksperienca në Muza, si do ta përshkruanit?

Si në çdo eksperiencë, ku synimi është që të sjellim gjëra të bukura në jetët tona edhe puna do të bëhet më e vështirë, e sidomos në një eksperiencë si Muza Competition, ku çdokush, ka synim të jetë fitues. Eksperienca ime në Muza ka pasur shumë lodhje dhe stres, punë për orë e orë të gjata, e pa gjumë, por mbi të gjitha ka qenë e jashtëzakonshme. Besoj se diçka si Muza i duhej jetës time.

finalistë

MUZA

FASHION GROUP ALBANIA
fga
ALDO CARPISA CORTEFIEL GEOX MANGO
okaïdi PARFOIS Prenatal SPRINGFIELD women'secret
WWW.FGA.AL

ELITË SHERIFI

RIKTHIMI I TRADITËS

Koleksioni i stilistes nga Kosova Elitë Sherifi përcjell në një formë të freskët dhe inovative ndërthurjen e elementeve të tradicionales me modernen, duke reflektuar mahnitshëm sensualitetin, glamourin dhe elegancën. Një nga pikat e forta të stilistes është të krijojë veshje që shprehin feminilitetin, por edhe sigurinë e tyre në mënyra të sofistikuara dhe tërheqëse, duke përdorur materiale luksoze dhe detaje delikate. "Synimi im është të shkëlqej në mënyrë që të frymëzoj dhe të krijoj një ndikim të fortë për të gjithë ata që veshin krijimet e mia"- thekson stilistja.

Koleksioni Muza quhet Rikthimi i Traditës. Pse keni zgjedhur këtë etiketim?

Në këtë koleksion vendosa të rikthej traditën e veshjeve me një frymë moderne. E quajta koleksionin "Rikthimi i Traditës" për shkak të disa arsyeve të rëndësishme. Për mua, kjo ishte një mënyrë për të nderuar dhe respektuar trashëgiminë tonë kulturore, duke sjellë traditat në jetë në një mënyrë të freskët dhe inovative. Një prej arsyeve kryesore ishte për të shfaqur mrekullitë e traditave. Shpeshherë, në vazhdimin e modernizimit dhe globalizimit, traditat e veshjeve kanë humbur rëndësinë e tyre. Me këtë koleksion, unë synova të rikthej ndjenjën e rëndësisë së traditave të veshjeve dhe t'i jap një vend të merituar në kulturën tonë. Në të njëjtën kohë, quajta koleksionin tim "Rikthimi i Traditës" sepse dëshiroja të shfaqja kreativitetin tim dhe aftësinë për të përdorur traditat si burim frymëzimi. Duke kombinuar elemente tradicionale me detaje të reja dhe moderne, arrita të krijoja veshje të veçanta që shprehin identitetin tonë kombëtar në një mënyrë të freskët dhe të sotme. Koleksioni ka për qëllim të sjellë traditat e veshjeve në fokus, duke u përpjekur të mbajmë lidhjen me trashëgiminë tonë kulturore dhe të shfaqim një version modern të tyre. Shpresoj të frymëzoj të tjerët, të vlerësojnë dhe të rikthejnë trashëgiminë e veshjeve në një mënyrë kreative dhe inovative.

Për shumë stilistë, kombinimi i modernes me tradicionalen janë një sfidë, po për ju si ka qenë?

Si stiliste, kombinimi i modernes me tradicionalen ka qenë një sfidë emocionuese dhe frymëzuese. Është e vërtetë që të sjellësh dy elemente kaq të ndryshëm bashkë dhe t'i japësh një ndjenjë harmonike dhe të përshtatshme është një punë sfiduese. Fillimisht, ishte e rëndësishme të eksploroja thellësisht traditat dhe veshjet tradicionale të kulturës. Kjo përfshinte kërkimin e historisë së veshjeve tradicionale, duke

kuptuar materialet, teknikat dhe elementet e dizajnit të përdorura. Kjo më lejoi të krijoj një bazë solide për të punuar mbi të. Pastaj, u përqendrova në identifikimin e elementeve moderne që mund të kombinoheshin me traditën. Përdorimi i materialeve dhe modeleve të reja dhe eksperimentimi me forma e detaje të sotme ishin pjesë e procesit. Gjithashtu, u fokusova në të gjeturit e një balance midis aspektit tradicional dhe asaj moderne, duke siguruar që veshjet të mos humbasin identitetin kulturor dhe të jenë aktualizuar për t'ju përgjigjur kohës. Është vërtetuar se kombinimi i traditës me modernen në veshje ka shumë potencial për të krijuar një shfaqje të veçantë dhe të jashtëzakonshme. Në këtë proces, pata mundësinë të shfaqja kreativitetin tim maksimal dhe të eksploroja ndryshimet që mund të ndodhin kur elementet tradicionale takohen me influencat e reja. Kjo përvojë më ka sjellë një ndjenjë të re frymëzimi dhe më ka hapur derën për të eksperimentuar më tej në fushën e kombinimit të traditës me modernen.

Cila ka qenë ajo krahinë e cila ju ka frymëzuar përsa i takon veshjes dhe pse e zgjodhët atë?

Të gjitha trojet shqipfolëse kanë një trashëgimi të pasur dhe të veçantë në fushën e veshjeve tradicionale. Për mua, secila krahinë sjell një identitet unik dhe një estetikë të veçantë nëpërmjet veshjeve tradicionale. Kjo përfshin motive të ndryshme, teknika të punimit, ngjyra dhe stile të veçanta që përcjellin historinë, kulturën dhe trashëgiminë. Duke marrë frymëzim nga të gjitha trojet shqipfolëse, synoj të përfaqësoj bukurinë e diversitetit kulturor dhe traditat e ndryshme nëpërmjet koleksionit tim.

Në koleksionin tuaj spikatin tirqet, një detaj me pafundësi kombinimesh, ju si e kanë modernizuar?

Për të modernizuar detajin e tirqeve në koleksionin tim, kam eksperimentuar me disa kombinime dhe elemente të reja që i japin një freski dhe modernitet veshjeve tradicionale. Një ndër mënyrat ka qenë kombinimi i tirqeve tradicionale me materiale të reja dhe detaje bashkëkohore. Kam eksperimentuar me materiale të lehta dhe transparente për të krijuar një ndjenjë të hollë dhe të frymëzuar nga moda moderne.

Modernizimi i tirqeve u arrit përmes eksperimentimit me aplikime, forma, materiale dhe tekstura të ndryshme.

Qëndismat dhe thurjet me grep sivjet janë IN botërish, si vijnë ato të konceptuara nga Elitë?

Qëndismat dhe thurjet me grep kanë bërë një kthim të madh në botën e modës sivjet dhe kanë fituar popullaritet në nivel global. Kjo tendencë është pjesë e një koncepti më të gjerë të modës që promovon vlerat autentike, artizanale dhe tërheqjen nga prodhimet masive. Për mua, qëndismat dhe thurjet me grep janë një burim i pasur për kreativitetin, dhe unë kam shfrytëzuar këtë potencial për të krijuar veshje të mahnitshme. Përmes kësaj përpjekje për të kombinuar traditën dhe modernen, synoj të sjell një frymë të re dhe të freskët në botën e qëndismave dhe thurjeve me grep.

Të gjithë stilistët kthehen gjithmonë tek e shkuara, pse stilistët shqiparë duhet të kthehen tek tradita?

Stilistët shqiptarë kthehen tek tradita sepse ajo ka një identitet kulturor të pasur dhe trashëgimi të çmuar. Duke u frymëzuar nga tradita, mund të shprehim një pjesë të veçantë të identitetit tonë kombëtar në botën e modës. Kthimi tek tradita nuk do të thotë të kopjojmë, por të eksplorojmë dhe të kombinojmë elemente tradicionale me inovacion dhe kreativitet. Kjo na jep mundësinë të krijojmë veshje të unike, tërheqëse dhe të ndryshme nga ato që ofrohet në treg. Kështu japim edhe një kontribut në ruajtjen dhe promovimin e pasurisë tonë, duke e sjellë atë në skenën ndërkombëtare të modës.

Në dizajnet tuaja spikat sensualiteti, glamour-i, propozimet për në Muza do të kenë të njëjtën frymë?

Faleminderit për vlerësimin. Në dizajnet e mia, përpiqem të sjell një kombinim të mahnitshëm të sensualitetit, glamour-it dhe elegancës. Unë kërkoj të krijoj veshje që shprehin feminitetin dhe sigurinë e tyre në mënyra të sofistikuara dhe tërheqëse. Propozimet e mia për Muza, tërheqin frymën e një elegancë klasike. Përdorimi i materialeve luksoze, detajet delikate dhe stilizimet e siluetave janë disa nga elementet që kontribuojnë në krijimin e kësaj fryme. Synimi im është të shkëlqej në mënyrë që të frymëzoj dhe të krijoj një ndikim të fortë për të gjithë ata që veshin krijimet e mia. Në veshjet e mia, kam përdorur shqiponjën si një simbol i identitetit kombëtar, ku kam eksperimentuar edhe me formën e veshjeve për të përkthyer shqiponjën në dizajn. Për shembull, forma e një fustani do të jetë e strukturuar në mënyrë që të krijojë iluzionin e siluetës së shqiponjës. Kjo do të realizohet përmes linjave të formave, dorezave, ose aplikimeve të ndara në mënyrë strategjike. Me përdorimin e shqiponjës si element në veshje, synimi im është të shpreh ndjenjën e unitetit, krenarisë kombëtare dhe dashurisë për vendin.

Si ka qenë kjo eksperiencë për ju në Muza?

Eksperienca në Muza ka qenë e jashtëzakonshme dhe frymëzuese, një sfidë e madhe, por gjithashtu një mundësi e mrekullueshme për të shfaqur krijimet e mia para publikut. Në Muza, kam pasur mundësinë të ndaj vizionin tim artistik dhe kreativ me profesionistë të tjerë të industrisë së modës. Kam pasur mundësinë të prezantoj koleksionin tim para ekspertëve dhe të marr vlerësime, kritika dhe inspirim nga njerëzit e talentuar të industrisë. Muza ka qenë një platformë unike për të shfaqur aftësitë e mia si stiliste dhe për të hapur dyert për më shumë mundësi në karrierën time. Njëherazi, kam patur mundësi të njihem dhe të mësoj nga stilistë të tjerë, modele dhe profesionistë të modës, duke zgjeruar rrjetin tim të kontakteve dhe krijuar mundësi për bashkëpunime në të ardhmen. Nga ky kompeticion, pres të fitoj përvojë të çmuar, njohuri të reja dhe vlerësime profesionale. Pres të përparoj dhe të rritem si stiliste, duke u frymëzuar nga ide dhe tendenca të ndryshme të modës, si dhe duke u zhvilluar në nivelin personal dhe profesional. Jam përkushtuar për të dhënë më të mirën dhe për të shprehur vizionin tim në mënyrën më të përsosur dhe origjinale të mundshme.

finalistë

MUZA

BLUE DOT CONSULTING

SHAPE YOUR FUTURE

@BlueDotConnect

EXPLORE

www.bluedot-consulting.com

KEVSER EMINI

PJESËZA ARTZMIXAL

Ende një studente, Kevser Emini nga Maqedonia e Veriut ka arritur që të udhëtojë jo vetëm në një vend, por në disa krahina për të mbledhur pjesëza nga kultura dhe etnografia, e më pas të gjitha bashkë janë përzier në një koleksion mahnitës. Ndryshe nga konkurrentët e tjerë, Kevser ka krijuar një koleksion ku kanë pjesë edhe veshjet për meshkuj, një zgjedhje e zgjuar kjo mes garuesve të tjerë. Eksperienca e saj në Muza ka qenë hapi i parë drejt botës së stilimit, ndaj nuk kishte sesi të mos e konsideronte, si eksperienca më e bukur dhe e paharrueshme jetësore.

Çfarë ka të veçantë ky koleksion që prezanton në Muza?

Koleksioni që prezantoj në Muza është koleksioni im i parë me 10 veshje. Deri tani kam marrë pjesë vetëm në sfilatat e universitetit, nuk është se kam një brand që krijoj për klentët. Me aq sa kam krijuar deri tani edhe në Muza sjell një stil të njëjtë, por pa dyshim që është diçka e veçantë, ngaqë deri tani nuk është që kam dizajnuar diçka në kombinim me tradicionalen.

Pse keni zgjedhur ti vendosni koleksionit emrin "Pjesëza Artzmixal"?

Koleksionit tim i vendosa emrin "Pjesëza Artzmixal" që nënkuton Pjesëza nga (ARTZ- Artizanati, MIX- i përzier, AL -Albanian/ Shqiptar).

Nga jeni frymëzuar më së shumti për të krijuar, cilat janë krahinat?

Koleksioni im nuk është inspirim i një vendi apo krahine në veçanti, por është kombinim krahinash e pjesëzash. Ato krahina janë: Reka e Epërme, Medvegja, Mirdita, Tetova, Tirana e shumë të tjera. Pastaj si pjesëza kam zgjedhur: tirqin, brezin, kollanin, jelekun, gjithashtu dhe një motiv nga qilimat shqiptarë. Zgjodha këto krahina e pjesëza, sepse me pëlqenin shumë dhe me dukeshin më të veçanta. Por edhe sepse dëshiroja që të tregoja sa më shumë nga tradita jonë e pasur, si veshjet dhe aksesorët e krahinave të ndryshme, po ashtu edhe mënyrën artizanale me të cilën ato janë punuar.

Ju merrni pjesëza, i miksoni dhe stilizoni, si është ky proces, ndryshe nga stilizimi i një veshje?

Unë marr pjesëza i miksoj dhe i stilizoj, ndryshe nga të gjitha veshjet, ngaqë jam një shpirt shumë krijues dhe asnjëherë nuk më mjafton një inspirim. Gjithmonë kam dëshirë të jap sa më shumë, sidomos kur bëhet fjalë për promovimin e etnografisë shqiptare. Edhe pse janë shumë komponentë, si përfundim mbaj vetëm një linë. Me një fjalë, shumë gjëra të ndryshme, por të kombinuara shumë mirë njëra - tjetrën. Mendoj që kjo e bën shumë më të veçantë koleksionin tim në Muza, ndryshe nga stilizimi i një veshje.

Pse zgjodhët, gajtanin një simbol tipik ceremonial shqiptar?

Gajtani një simbol tipik ceremonial shqiptar dhe i pranishëm në çdo veshje tradicionale, padyshim që nuk duhej të mungonte në një koleksion ku duhet te promovohen veshjet tradicionale shqiptare.

Të gjithë stilistët kanë subjekt gruan, ju keni në koleksion edhe veshje për burra, pse?

Ngaqë të gjithë stilistët kanë subjekt gruan dhe të gjithë kanë synim veshjet Couture dhe Glam, unë dua që të krijoj dhe për meshkuj. Mendoj që të jesh unik, të duhet të analizosh se çfarë mungon dhe për çfarë kemi nevojë, jo të shohësh se çfarë bëjnë të tjerët. Me këtë dëshiroja të tregoja edhe synimin që unë kam si një dizajnere e ardhshme. Nuk është që do të krijoj vetëm për meshkuj në të ardhmen, por gradualisht për të dyja gjinitë. Por në Muza ishte e rëndësishme sepse nëse të gjithë do të vazhdojmë që çdo sezon të bëjmë veshje vetëm për gra, atëherë do të ketë risi vetëm në veshjet tradicionale të grave, ndërsa tek burrat do të kishim dekada pa u ndryshuar.

Koleksioni ndërthur të kuqen dhe bardhë e zi, çfarë kanë ato të veçantë?

E kuqja e bardha dhe e zeza, janë ngjyrat më të pranishme në veshjet tradicionale shqiptare, prandaj vendosa që në koleksionin tim dedikuar Muza Competition të dominojnë pikërisht këto ngjyra.

Ju zgjidhni një stil "casual", mendon se tradita mund të kthehet në veshje të përditshme?

Po, mendoj që nëse duam t'i mbajmë dhe promovojmë sa më shumë veshjet dhe motivet tradicionale, ne duhet që ato t'i kthejmë në veshje casual, pra të përditshme. Veshjet tona tradicionale punohen me materiale shumë të trasha dhe kanë shumë punime dore, pra në kohën që jemi, nuk janë të përshtatshme dhe janë të vështira për t'u mbajtur në përditshmëri. Për këtë arsye është më mirë që ato të kthehen në casual. Nuk po them që ato të ndryshojnë, por që stilistët e rinj duhet të cekin ato që janë si inspirim. Në këtë drejtim veshjet origjinale tradicionale nuk do të jenë kurrë të lëna pas dore, sepse për të krijuar një këmishë me një motiv, duhet të studiosh veshjet tradicionale. Kur e vesh atë këmishë në punë, në shkollë, për një shëtitje apo jashtë vendit, ti promovon kulturën. Vetëm në këtë mënyrë mund të vazhdojmë të mbajmë gjallë dhe të pranishme veshjen tradicionale dhe kulturën në përgjithësi.

A mund të më përshkruash si ka qenë periudha krijuese për Muza?

Muza si eksperiencë për mua ka qenë shumë e veçantë. Ishte një moment ku kisha dëshirë të bëja diçka, që të tregoja veten si dizajnere e ardhshme. Më gëzon fakti që jam pjesë e finales dhe kjo më bën krenare. Më dha shenjë që unë jam shumë e mirë në këtë drejtim dhe një ditë, kur të kryej studimet dhe do të kem eksperiencë si dizajnere, padyshim që do të arrij të shkoj edhe më shumë. Lëvizjet Shkup - Tiranë ishin ndonjëherë të lodhshme, por nuk i ndjeva fare. Tiranën e kisha njohur, por kësaj radhe e njoha nga afër, sepse nuk është që vetëm e vizitoja, por pata kontakte me shumë njerëz dhe e pashë shumë më ndryshe. Gjithashtu, ajo që bëjmë në Muza është në të mirë të kulturës tonë shqiptare, e bën krijimtarinë edhe më të veçantë për mua. Muza është dhe do të jetë eksperienca më e bukur dhe e paharrueshme jetësore, për faktin që këtu prezantova koleksionin tim të parë. Një koleksion të parë nuk do të mundrj të prezantohej më mirë dhe më bukur, se sa në këtë mënyrë siç ishte organizuar Muza.

finalistë

MUZA

0686030734 geraldina_sposa

Ne veshim ëndrra!

LIRIDONA HAJDARI
FOLK

Liridona ka arritur të reflektojë qartazi mbi koleksionin e saj, duke prekur një pikë të modernes, që në fakt është kaq e prekshme dhe aktuale, sa e shohim në të gjitha sfilatat e stilistëve të ditëve të sotme. Elemente si oversized dhe beli i theksuar, motive që së fundmi kanë joshur mjeshtrit e dizajnit, e kanë nxitur Liridona Hajdarin që duke marrë detajet nga tradita, ti përkthejë ato në një koleksion i cili i dedikohet identitetit të femrës kosovare. E përkujdesur në zgjedhjen e ngjyrave, si e kuqja, e zeza dhe e bardha, stilistja nga Kosova, kombinon materialet e lëkurës e frymëzuar nga teknika e zhibonit, për të sjellë në Muza Competition një version tejet modern. "Ishte një sfidë jo e lehtë, sepse dëshiroja që të ndërthurja tradicionale me elementet moderne, ta paraqisja në mënyrën më të denjë të mundshme" – thekson stilistja nga Kosova.

Liridona si do ta përshkruanit koleksionin "Folk" që keni krijuar për Muza?

Koleksioni "Folk" manifeston veshjet e kulturës, traditës dhe identitetin e femrave kosovare, ku paraqet një trashëgimi të vyer të kulturës popullore kosovare dhe një simbol i nderit dhe dinjitetit të grave. Koleksioni reflekton ndjeshmërinë artistike të punimeve tradicionale të dorës.

Dominuese janë e bardha, e kuqja dhe e zeza, pse kjo zgjedhje?

Ngjyrat si e bardha, e kuqja, dhe e zeza, simbolizojnë më së miri veshjet tradicionale shqiptare. Ku e kuqja është ngjyra kryesore shqiptare dhe ka kuptimin simbolik të fuqisë, dinjitetit dhe rezistencës, patriotizmit dhe vendosmërisë. E zeza, për të theksuar kontrastin dhe elegancën: ajo simbolizon forcën dhe hidhërimin, por gjithashtu përdoret si ngjyrë për të harmonizuar dhe për të shfaqur kontrastin mes ngjyrave të tjera. Nga ana tjetër, e bardha është një ngjyrë e cila është e përdorur gjerësisht në traditat shqiptare dhe ajo simbolizon pastërtinë, flijimin dhe dritën.

Ju alternoni lëkurën e pëlhurën e frymëzuar nga teknika e zhibonit, si e sillni në versionin modern?

Lëkura ka luajtur një rol mjaft të rëndësishëm në veshjet tradicionale shqiptare. Ajo ka ofruar rezistencë, mbrojtje, por edhe një estetikë karakteristike për veshjet tradicionale, duke i dhënë atyre një identitet të veçantë dhe një ndjenjë unike. Lëkura është përdorur gjithashtu edhe për të krijuar detaje apo dekorime të ndryshme, si aplikime të punuara me dorë, gërryerje, si dhe kombinime (ngjitje) të lëkurës në fustane, xhaketa apo pantallona.

Koleksioni promovon traditën, por edhe sfidon modernen, si ka qenë kjo sfidë për ju?

Ishte një sfidë jo e lehtë, sepse dëshiroja që të ndërthurja tradicionalen me elementet moderne, ta paraqisja në mënyrën më të denjë të mundshme. Kjo përzierje e traditës dhe modernes krijon një stil unik dhe të freskët që reflekton një ndërgjegje të përbashkët të identitetit kulturor dhe zhvillimit të shoqërisë.

Ju përgëzoj për linjën "oversized", pse keni zgjedhur këtë koncept?

Ndërthurja e linjës oversized me veshjet tradicionale sjell një ndjenjë të re por edhe moderne në pamjen e tyre, duke ndryshuar përshkallëzimin e formës tradicionale të trupit. Kjo lloj përzierje mund të japë një perspektivë të re për veshjet tradicionale dhe t'i japë atyre një ndjenjë akoma edhe më bashkëkohore.

Beli i theksuar është IN, cilat elemente tradicionale keni përdorur për ta nxjerrë atë në pah?

Beli i theksuar është një element i rëndësishëm në veshjet tradicionale shqiptare. Kjo vlen veçanërisht për fustanet dhe xhaketat. Unë personalisht si element kyç, kam përdorur korsenë prej lëkure si dhe brezat me motive tradicionale. Beli i theksuar në veshjet tradicionale shqiptare është përdorur në tregimin e historive personale, për shembull,: ngjyrat dhe dekorimet e belit mund të tregojnë për statusin martesor, të ardhurat ose përkatësinë etnike të personit që e mban atë të veshur.

Linja juaj është Ready to Wear, si e keni menduar për një treg më masiv?

Ready to Wear ka një përshtatshmëri të madhe për tregun masiv dhe ka qenë një koncept që ka evoluar dhe fituar një popullaritet të madh në industrinë e modës. Kjo lloj linje është e dizajnuar për të kënaqur kërkesat e një audience të gjerë, duke përfshirë persona me shije dhe grupmosha të ndryshme. Për të pasur sukses në tregun masiv, mendoj që një pjesë shumë e rëndësishme është edhe përdorimi i materialeve cilësore dhe duke ofruar dizajne të ndjeshme estetike, që i japin shfrytëzuesit një përvojë të mirë të blerjes dhe veshjes.

Çfarë ju ka bërë më shumë përshtypje në këtë eksperiencë me Muza?

Kjo eksperiencë ka qenë shumë emocionuese dhe një sfidë e madhe për mua. Unë dhashë maksimumin për këtë garë dhe kjo personalisht më ka sjellë emocione të shumta si: gëzim, stres dhe eufori. Përfundimisht ishte një eksperiencë unike dhe më mundësoi për ta vënë veten në provë, por edhe për të zhvilluar aftësitë e mia akoma edhe më shumë. Në fund të fundit, kjo ishte një mundësi për të mësuar dhe për të krijuar kujtime të paharrueshme.

finalistë

MUZA

GRACE MODELS MANAGEMENT & PROFESSIONAL COURSES

Apliko këtu

PROFESIONALIZËM
STANDARD
HIJESHI

+355 69 22 777 00

GRACEMODEL.AL@GMAIL.COM

GRACEMODELS-ALBANIA.COM

Grace Models

Grace Beauty Center

AG aga clothing



KLEVISA SHKABA

ARBËRESHA

POP ART

Një udhëtim përtej Adriatikut, në mes të komunitetit arbëresh, mes veshjeve të mrekullueshme të shqiptarëve, por të sjella në një formë më moderne, atë pop art. Kjo zgjedhje e Klevisa Shkaba, ka qenë e veçantë, sepse ngjyrat e forta të mbajtura gjallë në kulturën arbëreshe, në dukje mund të ngjajnë si një kombinim i bukur, por në fakt janë tejet të vështira. Stilistja e re ka arritur të kombinojë detajet më tipike të etnosit arbëresh, duke zëvendësuar të gjelbrën e ndezur me jeshilen ushtarake të viteve '90-të, alternuar me nuancat e tokës dhe të artën. Ndërkaq, aksesorët shoqërues janë kryesisht shamia e kokës dhe qeleshja, ndërsa risi është vegla e dajres, e cila është transformuar në një çantë.

Në fillim doja të pyesja, sa kohë ju desh të studioni dhe realizoni koleksionin tuaj?

Për realizimin e skicave mu deshën pothuajse 2 javë. Gjatë këtyre dy javëve vizitova disa muze dhe u inspirova nga etnografia shqiptare. Ndërsa për realizimin e veshjeve. m'u deshën afërsisht 3 javë për t'i prerë dhe qepur.

Keni zgjedhur një element të rrallë etnografik, gruan arbëreshe, çfarë kishte ajo unike për ju?

Arbëreshët kanë shumë tradita dhe zakone unike. Për shembull, ata kanë gjuhën e tyre, që është një variant i shqipes. Ata kanë gjithashtu veshje tradicionale, muzikë, valle dhe kuzhinë. Arbëreshët njihen për ndjenjën e tyre të fortë të komunitetit dhe vlerave familjare.

Emri i koleksionit "O moj e bukura Arbëreshe", si do ta përkufizoje stilin e një arbëreshe?

Kultura arbëreshe është shumë e pasur dhe unike. Ajo ndërthur elementë nga kultura shqiptare dhe italiane, pasi arbëreshët emigruan në Itali shekuj më parë. Kultura arbëreshe njihet për muzikën, vallëzimin dhe kuzhinën tradicionale.

Pse keni kombinuar veshjet arbëreshe me pop artin, një zgjedhje avangarde?

Si kultura arbëreshe, ashtu edhe arti pop, përdorin ngjyra të ndezura dhe të guximshme në stilet e tyre përkatëse. Veshjet popullore arbëreshe për shembull, janë të njohura për ngjyrat e tyre të gjalla dhe qëndisjet e ndërlikuara, ndërsa arti pop, shpesh përdor ngjyra të ndritshme, të kundërta dhe linja të theksuara për të krijuar një ndikim vizual të mrekullueshëm. Pra, në këtë kuptim, ato të dyja ndajnë një fokus të ngjashëm në përdorimin e ngjyrës, në stilet e tyre përkatëse.

Çfarë materialesh përbëjnë koleksionin dhe me çfarë aksesorë e shoqëroni?

Për koleksionin "O moj e bukura arbëreshe", kam përdorur materiale të ndryshme si: stofi, thesi, teritali, sateni si dhe shumë të tjera. Ndërkohë, veshjet i kam shoqëruar edhe me aksesorë si: shami në kokë, qeleshe, dajre në formë çante, monedha ari, çentro e shumë elemente të tjera.

Ju sillni shumë ngjyra, cilat janë ato më karakteristike që dominojnë dhe pse?

Kam përfshirë shumë ngjyra komplementare dhe analoge. Kam përdorur dhe ngjyrën ushtarake që është elementi kryesor i viteve 90-të. Po ashtu edhe ngjyrat neutrale të tokës, që janë tipike të ilirëve si dhe ngjyrën gold , e cila nuk mungon në veshjet popullore.

E përshkruani si elegante gruan arbëreshe, ku konsiston ajo?

Identiteti i fortë i ndërgjegjes etnike dhe gjuhësore është gjithmonë i pranishëm në popullsinë arbëreshe. E kam

përshkruar elegante me transparencë gruan arbëreshe, pasi njeriu duhet të jetë i pastër në fund të ditës.

Sa e mundur është për një stilist të evokojë të shkuarën tek modernia?

Siç e dimë çdo gjë e ka një histori nga e kaluara, unë kam marrë shumë elemente etnografike. Vite më parë ka pasur vështirësi jetese dhe luftëra, këto vështirësi si "katarsis", e kanë bërë njeriun që të krijojë art duke e parë artin si shpresën më të fortë.

A mund të na përshkruani si ka qenë eksperiencë në Muza?

Eksperienca ime në Muza ka qenë eksperienca më e bukur që kam kaluar, pasi këto muaj mësova pafund gjëra të bukura. Çdo ditë kam punuar me dëshirën më të madhe për t'i ndarë më të tjerët, në një publik kaq të madh dhe me profesionistë të artit nga trevat shqiptare. Falënderoj Muza Competition për mundësinë që i jep të rinjve si unë që të shfaqin idetë e tyre dhe për të ruajtur traditën etnografike shqiptare, gjithashtu edhe Unionin e Bashkive për organizimin e këtij eventi.

finalistë

MUZA







ALB ACADEMY
ZHVILLO BIZNESIN TËND

Zgjero mundësitë e tua të karrierës

- *TRAJNIME PROFESIONALE*
- *KONSULENCA BIZNESI*
- *PROJEKTE*

Need a Expert? We Help You

info@albacademy.al
067 401 00 45
www.albacademy.al

Afërdita Onuzi

ZONJA E **XHUBLETËS** SHQIPTARË

Mbi 50 vite jetë dedikuar xhubletës, e jo vetëm, ndaj jo më kot e therrësin si zonja e xhubletës shqiptare. Takimi i saj i parë me këtë pasuri kombëtare, ka ndodhur në qershor të vitit 1972, e që prej atij çasti, ajo nuk është ndarë asnjëherë nga dëshira për të eksploruar, studiuar dhe mbrojtur një prej trashëgimive më të mëdha të vendit tonë. Afërdita Onuzi, etnografja e njohur vendosi që një vit më parë ti bashkohet Muza Competition, duke ndarë dijet e saj rreth veshjeve tradicionale dhe etnosit tonë kombëtar me mijëra të rinj, të cilët janë bërë pjesë e kësaj gare. Në këtë intervistë ajo rrëfen për karrierën e saj, por edhe eksperiencën me Muza, duke vlerësuar gjithashtu edhe rolin e të rinjve në rigjallërimin e veshjeve tradicionale nga të gjitha krahinat shqipfolëse si dhe modernizimin e tyre.

Si ndiheni kur ju thërrasin Afërdita e xhubletës shqiptare?
Mendoj se ky është përtej çdo vlerësimi tjetër. Për mua është kënaqësi dhe lumturi shumë e madhe.

Sa vite karrierë i keni dedikuar xhubletës?
Që nga qershori i vitit 1972, pas ekspeditës kërkimore që kam patur në Nikaj - Mertur, një tjetër në Dukagjin dhe disa të tjera në Malësinë e Madhe dhe në Tuz të Malit të Zi.

Si ju dukën konkurentët e Muza si dhe temat që ata kanë përzgjedhur?
Konkurentët e edicionit të dytë të Muza Competition, por edhe temat që ata zgjodhën për të konkuruar, ishin mjaft seriozë në angazhimin e tyre, por duhen trajnuar më përpara me informacione dhe literaturë.

Kemi veshje nga çdo krahinë, Muza po i ringjall, si e vlerësoni këtë nismë?
Edhe pse nuk kishte stilime të veshjeve nga të gjitha krahinat dhe kjo është mëse e kuptueshme, konkurentët i përzgjodhën ato sipas njohjeve dhe preferencave të tyre. Gjithsesi mendoj se u hodhën hapa shumë të mirë.

Cilat prej veshjeve që janë marrë si frymëzim ju kanë pëlqyer më shumë?
Përgjithësisht më pëlqyen veshjet ku mbizotëronte ngjyra e bardhë, sepse pikërisht ajo është edhe ngjyra bazë në veshjet tona popullore.

A patët ndonjë konkurrent të preferuar?
Konkurentët më të preferuara për mua ishin: Vitorja nga Lezha, Frenki nga Tirana dhe Besa nga Maqedonia.

Cila krahinë mendon se ka një pasuri folklorike e cila mund të përshtatet lehtësisht me modën sot?
Të gjitha krahinat kanë veshje mjaft interesante, por më lehtësisht dhe më interesante me krijimet e ditëve të sotme, do të ishin disa nga llojet e këmishave dhe të xhokeve, si tek veshjet e burrave, por edhe ato të grave. Po ashtu dhe dekori i tyre është tepër interesant dhe ka vlera të rralla artistike.

A keni një mesazh për të rinjtë që duan modernen dhe duhet të njohin traditën?
Mesazhi im për krijuesit e rinj është: Të njohin të kaluarën, për të ndërtuar të ardhmen…

globalwomanmagazine.com

Global Woman™

Magazine
ALBANIA

THE POWER OF WOMEN SHIFTING THE WORLD

“SIVJET SKENA ISHTE MË E BUKUR, KONKURENCA ISHTE RRITUR, NDAJ JAM KËTU PËR TI DHËNË PËRKRAHJE KREATORËVE TË RINJ. EKZISTON MUNDËSIA QË KONKURRETËT E MUZA TË KENË SUKSES AKOMA MË TË MADH NË TË ARDHMEN, NËSE VAZHDOJNË DHE KRIJOJNË KOLEKSIONE TË VETA, PASI KY ËSHTË VETËM HAPI I TYRE I PARË. BESOJ SE NË TË ARDHMEN GJITHÇKA DO TË AVANCOJË DHE NDOSHTA DO TË KETË NJË JAVË MODE NË TIRANË. TË RINJTË JANË AMBASADORËT MË TË MIRË TË ÇDO SHTETI, QOFSHIN NGA SHQIPËRIA, KOSOVA, MALI I ZI APO MAQEDONIA E VERIUT.”

EMINA ÇUNMULAJ



NJË EVENT I TILLË KA QENË NJË ËNDËRR E IMJA PREJ SHUMË KOHËSH, MADJE KEMI FILLUAR TA BËJMË PARA SHUMË VITESH, ME ATO KUSHTET TONA ME SHUMË ARTISTË. BESOJ SE PËR ÇDO STILIST QË KA NJË PRODUKT TË MIRË, SUKSESI DO TË VIJË. KËTA TË RINJ QË JANË PJESË E MUZA KANË NJË SHANC SHUMË TË MIRË, SEPSE KRIJIMET E TYRE BËHEN PJESË E NJË SHOW, I CILI I JEP SHUMË FUQI KRIJIMEVE TË TYRE. PO SHOH SE NGA VITI NË VIT KONKURRENTËT AVANCOHEN. DEFINITIVISHT SIVJET ËSHTË SHUMË HERË MË MIRË DHE NIVELI ËSHTË RRITUR DUKSHËM.

FADIL BERISHA

“MUZA COMPETITION ËSHTË KAQ FRYMËZYESE. MË PËLQEN SEPSE ËSHTË EVENTI I VETËM DHE UNIK I KËTYRE PËRMASAVE, I CILI MBAHET NË TIRANË, I CILI PËRQAFON TË GJITHË AUDIENCËN NË TROJET SHQIPFOLËSE DHE KJO ËSHTË MERITË E ORGANIZATORES ANDRIOLA KAMBO.
MUZA ËSHTË NJË GARË E CILA NXJERR NË PAH TALENTET E MODËS, POR AJO QË E BËN TË VEÇANTË, ËSHTË NDËRTHURJA E MOTIVEVE POPULLORE ME KRIJIMET MODERNE, TË CILAT KANË FATIN TË SHFAQEN NË PASARELË, POR EDHE TË VLERËSOHEN NGA NJË JURI SHUMË PRESTIGJIOZE.
MUZA KONTRIBUON NË NJOHJEN E TRADITËS, POR EDHE NA MËSON SESI TA NDËRTHURIM DHE HARMONIZOJMË ME TENDENCAT E FUNDIT.
ARRITJA MË MADHE E KËTIJ EVENTI ËSHTË QË TRADITA TË MOS MBETET E EKSPOZUAR VETËM NË MUZE, POR NA FRYMËZON SESI ATË TA KTHEJMË LEHTËSISHT NË VESHJE TË PËRDITSHME...!”

ENADA
AT‘NIKOLLA



EXPERIENCE THE CITY IN STYLE WITH MARRIOTT TIRANA

marriott.com/TIAMC marriotttirana Tirana Marriott Hotel

“KA AVANCUAR ORGANIZIMI DHE KONKURENTËT E MUZA COMPETITION. MË PËLQEN IDEJA QË EVENTI NUK ËSHTË KLISHE, POR ËSHTË I KURUAR DHE KA SFILATË ME MODELE PËR PREZANTIMIN E ÇDO KOLEKSIONI. PREZANTIMI I TYRE ËSHTË NJË MUNDËSI SHUMË E MIRË PËR KONKURRENTËT, TË CILËT MUND TË MARRIN EDHE PROPOZIME PËR TË PASUR BASHKËPUNIME APO PUNUAR NË ATELIE TË NJOHURA. EKSPERIENCA QË ATA KANË FITUAR NË MUZA COMPETITION ËSHTË PADYSHIM SHKOLLA MË E MIRË PËR ÇDO STILIST TË RI DHE TË TALETUAR.”

VALDRIN SAHITI

HELIDON HALITI

Vallëzim me Muzën

"Talentet nuk mungojnë asnjëherë, thjesht duhen zgjuar dhe Muza këtë bën, i zgjon duke i ftuar në vallëzimin e saj tashmë të përvitshëm në hapa të qartë drejt thellësisë rurale me mjete kontenporane"

Artisti Helidon Haliti për të dytin vit rradhazi ishte jetë pjesë e jurisë së Muza Competition, për të vlerësuar me syrin e tij kritik, por edhe real, konkurrentët që garojnë për çmimin e madh. Në këtë intervistë ai rrëfen se Muza ka zgjuar interesin e atelieve të vogla si dhe të rinjve të talentuar, ndërsa tematika e sivjetshme ka thelluar interesin ndaj traditës shqiptare, e cila duke u gërshetuar me bashkëkohoren, do ti japë një rëndësi të veçantë Shqipërisë në botën e dizajnit.

Përsëri në jurinë e Muza Competition? Çfarë vlere ka për ju ky projekt?

Po, përsëri në juri në edicionin e dytë të MUZA dhe jam shumë i gëzuar për këtë, pasi eksperienca e vitit të kaluar ishte unike për mua dhe përkimet me koleget ishin të mëdha. Mendoj se syri i mprehtë i një piktori është shumë i nevojshëm në të tilla juri, pasi faza e parë eliminuese ose përzgjedhëse ka të bëjë me mënyrën se si konkurrentët vizatojnë apo prezantojnë koleksionin e tyre. Eksperienca e vitit të kaluar tregoi se unë kisha të drejtë në përzgjedhjen e disa konkurrentëve të cilat u paraqitën me vizatime minimaliste dhe pjesa tjetër e jurisë hezituan, por më pas të gjithë bashkë vumë re se konkurrentet u ri dimensionuan në medium dhe prezantimin final.

Teksa e keni një edicion shembull, çfarë mendoni se ka pikë më të fortë i dyti?

Edicioni i parë ka gjithmonë magjinë e fillimit dhe për pasojë të gjitha emocionet dhe risitë përmblidhen aty. Edicioni i dytë ka pjekurinë, maturinë dhe vijueshmërinë si dhe ecën më me stabilitet dhe ka mundësi të korrigjojë gabimet e të parit, gjë që në fakt unë nuk vura shumë re se kishte, por gjithsesi vetë vijueshmëria është një risi. Edicioni i dytë ka zgjuar më shumë atelie të vogla të cilat janë kaq të domosdoshme në Shqipërinë e post – diktaturës, pasi japin shembullin e tregut të lirë, thellojnë traditën apo shpërndajnë atë në mbarë botën, pasi produkti final do i përkasë edhe turizmit. Këtë vit vumë re se theksi i është vendosur edhe më shumë gërshetimit të traditës me elementet bashkëkohorë, si në demonstrimet fillestare apo në ato finale, pasi ndërthuret bukur eleganca e instalacionit të butë, me këmbënguljen e motiveve të traditës së hershme, duke ndihmuar dhe duke jo mohuar apo luftuar njëra -tjetrën.

Sa ju takon pjesëmarrësve këtë vit, si janë ata? Çfarë diference kanë nga ata të vitit të kaluar?

Pjesëmarrësit e sivjetshëm vijnë më të informuar dhe më të lexuar, për pasojë jemi në të njëjtat nivele të emocionit, por me një hap më përpara në eksperiencë. Talentet nuk mungojnë asnjëherë, thjesht duhen zgjuar dhe Muza këtë bën, i zgjon duke i ftuar në vallëzimin e saj tashmë të përvitshëm, në hapa të qartë drejt thellësisë rurale me mjete kontenporane. Thellësia rurale vjen me mjete moderne në kryeqytetin e shqiptarisë dhe bashkon të gjitha trevat dhe kulturat e zonave në një vallëzim me Muzën.

Tema e veshjeve që ju ka pëlqyer më shumë në këto koleksione, kush ka qenë?

Temat e veshjeve këtë vit kanë qenë më të studiuara dhe ka një tendencë drejt fabulave dhe miteve shqiptare, si një bashkëngjitje me novelat grafike apo fumeti, të cilat janë tashmë "të stampuara", qëndisura në veshjet e koleksionit të sivjetshëm dhe dalloj këtu Rozafën, zanat e malit apo legjendën e Argjirosë, të gjitha këto të prezantuara në mënyrë të tillë, si për të shënjuar një tendencë admiruese.

A fitoi një vit më parë i preferuari juaj?

Një vit më parë fitoi absolutisht e preferuara ime, të cilën e dallova që në skicat e para të cilat bënë skeptikë disa nga anëtarët e jurisë, por unë aty dallova një mendje tejet të evoluar, studiuar. Edhe më pas në intervistat përkatëse apo prezantimin final u mbrojt me mjeshtëri dhe klas të nivelit të lartë, ndaj jam i gëzuar për këtë dhe më erdhi mirë që juria i dha pikët maksimale me unanimitet. Por, e rëndësishme nuk është vetëm të fitosh, por edhe të mbrosh ecurinë tënde dhe kjo do të duket në vitet në vijim. A kemi bërë përzgjedhjen e duhur? Pasi të fitosh është një gjë dhe ta mbrosh atë është diçka tjetër.

Cilat janë kriteret që duhet të ketë fituesi sipas jush?

Kriteret e fituesit janë pikërisht ato që ka fituesja e sivjetshme, e shkolluar, me rrënjë në traditë, e mirë informuar, të dijë të vizatojë mirë, si me mjete tradicionale dhe ato digjitale dhe mbi të gjitha të prezantojë me dinjitet koleksionin në ekzekutimin final, qepje - montim si dhe përzgjedhjen e modeleve dhe të krijojë një frymë që publiku ta përqafojë, koleksioni të pëlqehet, të mbahet mend dhe të jetë sa më origjinal, duke përjashtuar plagjiaturat apo ndikimet që lehtësisht i gjejmë sot…!



MC 1

Muza Competition

Muza Competition, ngjarja më e rëndësishme e modës dhe dizajnit në Shqipëri mblodhi në këtë event madhështor personazhet më të njohur të televizionit, modelingut, artistë, influencer dhe sipërmarrës, të cilët të veshur me të zeza, i cili ishte edhe kodi i veshjes së mbrëmjes, parakaluan në tapetin e kuq. Edicioni i parë i Muza i organizuar nga Unioni i Bashkive në Rajon, pati të ftuar personalitete të njohura nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, duke e kthyer këtë eveniment në ngjarjen më të rëndësishme dedikuar talenteve në fushën e modës në gjitha trevat shqipfolëse.





MUZA
COMPETITIO



MC 1

Muza Competition

"Muza Competition" një projekt i ndërmarrë nga Unioni i Bashkive Shqiptare në Rajon, konkursi që bashkon tradicionalen dhe modernen dedikuar të rinjve në fushën e modës ishte ngjarja e vitit 2022. Projekti i dedikohet të rinjve nga mosha 18-35 vjeç nga qytetet shqipfolëse të rajonit të Ballkanit Perëndimor, për t'u ofruar atyre një spektër më të gjerë mundësish profesionale. Edicioni i parë ishte një befasi, pasi mijëra të rinj aplikuan për të garuar për çmimin e madh, ndërsa në fazën finale shkuan 10 prej tyre, të cilët konkuruan me krijime të frymëzuara nga motivet popullore të etnosit shqiptar. Juria e Muza Competition e përbërë nga: Fadil Berisha, Afërdita Onuzi, Emina Çunmulaj, Valdrin Sahiti, Enada At'Nikolla, Adriana Matoshi dhe Helidon Haliti, zgjodhën fituese, si dizenjatorja më e mirë Anisa Dudaj me koleksionin "Calidus", e cila u vlerësua me çmimin prej 20.000 eurosh. Vendin e dytë prej 10.000 eurosh e fitoi Kaonë Duriqi me koleksionin "Has", ndërsa çmimi i tretë prej 5.000 eurosh, u nda mes Kiara Musabelliut dhe Etnik Shala.

ALISA DUDAJ

FITUESJA E MUZA 1

“”

Alisa do të mbahet mend gjatë si fituesja e parë e Muza Competition, e cila rrëmbeu trofeun me vlerë prej 20 mijë eurosh. Ajo garoi me koleksionin “Calidus”, një emër i veçantë i cili vjen nga latinishtja dhe simbolizon aftësinë dhe mjeshtërinë për të krijuar. Ky koleksion sjell traditën shqiptare të parë në një këndvështrim minimalist. Një dualitet në thjeshtësinë e veshjeve në pamje të parë, por kompleksitetin e ka në detajet e mënyrës se si janë krijuar. Çdo copë dhe pëlhurë e përdorur është përzgjedhur me kujdes prej muajsh dhe më pas është punuar me dorë në mënyrë artizanale. Alisa është diplomuar si Fashion Designer në vitin 2022, me rezultatet maksimale, në Parsons School of Design në New York. Puna e saj ka marrë vlerësime të shumta, prej të gjithë profesorëve të saj, të cilët janë emra të shquar të modës në botë.

Alisa 1 vit pas edicionit të parë të Muza, çfarë ndjesisht kujtoni?

Mbas një viti që kur u ngjita në pasarelën e Muza Competition 2, kujtoj që kisha shumë emocione, sepse ishte hera ime e parë. Madje të njëjtat emocione që kisha herën time të parë u rikthyen përsëri.

Do të mbaheni mend si fituesja e parë e Muza, çfarë ju bëri fituese?

Mendoj që solla një risi në këndvështrimin për veshjet tradicionale. Më parë të gjitha koleksionet që janë frymëzuar nga tradita kanë qenë shumë të ngarkuara dhe nuk kanë pasur elemente kontenporane dhe minimalist. Vura re që dhe për Muzën Competition 2, kisha inspiruar pjesën më të madhe të konkurenteve.

Pas fitores, si ka qenë jeta e Alisës, çfarë solli trofeu në jetën tuaj?

Pasi fitova Muzën më kanë ardhur shumë mundësi. Jam e lumtur që isha pjesëmarrëse në këtë kompeticion sepse më erdhi mundësia të prezantoja koleksionin tim në një pasarelë ku mori vëmendje maksimale.

E keni ndjekur edicionin e dytë, ka diçka që ju ka bërë përshtypje?

Po e kam ndjekur dhe viti i dytë i Muza Competition ishte shumë interesant dhe me ide të reja.

Cili është mesazhi për të rinjtë që duan të ndjekin ëndrrën e stilimit?

Unë do i thoja të rinjve që nëse e kanë pasion dhe ëndërr stilimin duhet të krijojnë, duhet të përpiqen sa më shumë dhe të mos demoralizohen.

ALISADUDAJ

KAONE DURIQI

"HAS"

Kaone është fituesja e çmimit të dytë prej 10 mijë eurosh në edicionin e parë të Muza Competition. Koleksioni i saj quhej "Has" dhe është një kryqëzim ngjyrash të ndezura dhe të guximshme, të cilat shpalosin fuqinë e punës së dorës dhe modernes. Koleksioni Pranverë-Verë 2022 është frymëzuar nga veshjet tradicionale së zonës së Hasit dhe pikë e fortë janë ngjyrat e ndezura, qëndisjet dhe punimet e dorës. Motive, figura e simbole të ndryshme të përdorura në koleksion, bëhen cytëse e inspiruese për t'i njohur, rivitalizuar dhe gërshetuar me motivet e vjetra popullore shqiptare në artin e sotëm. Çdo pëlhurë është bërë nga riciklimi i dantellave të grumbulluara për 7 vite, të cilat shkojnë dorë në dorë me njëra-tjetrën. Veshjet kanë një ndjeshmëri unike, ku secila duke iu referuar detajeve transmeton emocione të rralla.

ETNIK SHALA

"ETNIKOGRAFI"

Çmimi i tretë i Muza u nda mes dy konkurrentëve, një prej të cilëve ishte edhe stilisti i talentuar nga Kosova, Etnik Shala
Duke marrë copëza nga tradita, djaloshi i talentuar arriti të realizonte një koleksion unik, duke rikrijuar një koleksion mbi motivet popullore. Duke përdorur xhubletën si një spunto, Etniku ka arritur të krijojë një koleksion ku spikasin alternimi i elegancës së dantellës dhe motiveve popullore, ku spikasin e kuqja dhe e arta, duke arritur të krijojë një siluetë tejet elegante dhe provokuese. Etniku ka qenë i lidhur me modën që në fëmijëri, edhe atëherë kur ende nuk e kuptonte si koncept. Që herët, familja e tij kishte vënë re një prirje të veçantë tek ai, jo më shumë drejt modës, sesa drejt së bukurës dhe artit në përgjithësi. Ai parapëlqen të jetë unik në krijimet e tij dhe eksperimenton më së shumti me stile të çuditshme, që e identifikojnë ndryshe.

KIARA MUSABELLIU

NË GUR

Edhe Kiara ishte fituese e çmimit të tretë të Muza. Në këtë koleksion Kiara ka gërshetuar tiparet ekzistente të veshjeve tradicionale shqiptare, duke i kombinuar me frymën moderne të paraqitura, e shpërfaqur dukshëm në elegancën femërore. "Kam përdorur linja të harkuara dhe të mprehta për të karakterizuar figurën e femrës shqiptare, nga ku jam bazuar edhe për emrin e koleksionit "Në Gur". "Guri është një element shoqërues i çdo miti dhe legjende shqiptare" – thekson stilistja Kiara Musabelliu. Çdo detaj i përdorur në veshjet e koleksionit, ku bien në sy qëndismat e realizuara me dorë dhe kombinimi me perla e rruaza, kanë krijuar veshjet tejet ekstravagante. Po ashtu interesant është kombinimi i materialeve transparente me ato më të rënda, si jelekë apo fustane, ndërsa theksohen elemente si jakët e mëngët e mëdha dhe me volum.

Muza Competition

3

EDICIONI I TRETË

po vjen...

Pas suksesit, jehonës dhe energjisë së papërshkrueshme të edicionit të dytë,
Muza Competition rikthehet në sezonin e tij të tretë...

MUZA COMPETITION ËSHTË NJË PROJEKT I NDËRMARRË NGA UNIONI I BASHKIVE SHQIPTARE NË RAJON, I CILI PËRFSHIN AKTIVIZIMIN E TË RINJVE PASIONANTË DHE PROFESIONISTË NË RIJETËZIMIN E ELEMENTEVE ETNOGRAFIKË NË FUSHËN E FASHION-DIZAJNIT.

APLIKONI

www.muzacompetition.com

muzacompetition

MUZA Competition

Muza Competition

Unioni i Bashkive Shqiptare në Rajon

BASHKIA TIRANË

MAHMUDIJE NIMANBEGU

EDLIRA TERZIU

ELDA SULAJ

KEJDI
BIRAÇI

VJONA
GASHI

JETA
JASHARI

BORDO

100% art, modë & stil jetese

E VETMJA REVISTË LIFESTYLE NË SHQIPËRI

ABONOHU

NJË VIT ABONIM NË BORDO
KUSHTON 5000 LEKË/ 40 EURO
KONTAKT: CEL: **+355 68 20 69 959**
E-MAIL: **INFO@BORDO.AL**